

# RAPORT VJETOR

**2025**



# SIGMA VIG

---



## Profili i Shoqërisë

**SIGMA VIG** është kompania e parë private e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, e licencuar dhe aktive në treg që prej vitit 1999. Që nga viti 2007, shoqëria është pjesë e grupit ndërkombëtar Vienna Insurance Group, një nga grupet lider të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Me një eksperiencë mbi 25-vjeçare në tregun vendas të sigurimeve, **SIGMA VIG** ushtron aktivitetin e saj në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke synuar rritjen e vazhdueshme të standardeve të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit për individët dhe bizneset. Veprimtaria e shoqërisë është e orientuar drejt ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme të mbrojtjes financiare, në përputhje me praktikën më të mira evropiane të industrisë.

Në vitin 2025, SIGMA Vienna Insurance Group vijoi të konsolidojë pozicionin e saj në tregun shqiptar të sigurimeve, duke u renditur ndër katër shoqëritë kryesore të sigurimit në vend për nga vëllimi i primeve të shkruara dhe duke zotëruar 12.69% të tregut të sigurimeve Jo-Jetë.

Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka operuar në një mjedis ekonomik dhe rregullator në zhvillim të vazhdueshëm, duke adresuar me sukses sfidat e tregut përmes një qasjeje të bazuar në profesionalizëm, qëndrueshmëri financiare, menaxhim të kujdesshëm të riskut dhe forcim të vazhdueshëm të strukturave organizative.

Pozicionimi i SIGMA VIG mbështetet në përkatësinë e saj në Vienna Insurance Group, një nga grupet më të mëdha të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, si dhe në eksperiencën e konsoliduar të ndërtuar ndër vite në tregun vendas. Këta faktorë i kanë mundësuar shoqërisë të ofrojë zgjidhje të besueshme sigurimi dhe mbrojtjeje financiare për individët dhe bizneset, duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit, pronës dhe aktiviteteve ekonomike të klientëve të saj.

Përmes këtij angazhimi, SIGMA VIG synon të krijojë vlerë të qëndrueshme për klientët, aksionarët, partnerët dhe komunitetin, duke mbështetur zhvillimin afatgjatë të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

# Rreth SIGMA VIG

## Emri i Shoqërisë

Sigma Vienna Insurance Group

## Data e Themelimit

Shkurt 1999

## Aktiviteti

Operon në biznesin e sigurimit të jo-jetës në Republikën e Shqipërisë dhe nëpërmjet degës së saj në Kosovë.

## Aksionerë Kryesor

Shoqëria mëmë **Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe**, Vjenë, Austri; e cila zotëron 89.05% të aksioneve

## Numri i punonjësve

132





## **BORDI**

---

### **BORDI MBIKQYRËS**

Z. Peter Höfinger Kryetar

Z. Christoph Rath Zv. Kryetar

Znj. Liane Hirner Anëtar

Znj. Sonja Raus Anëtar

Z. Jonard Prodani Anëtar

### **BORDI DREJTUES**

Z. Klaidi Çitozi

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Ervin Rali

Anëtar Bordi

Z. Artan Pjetërnikaj

Anëtar Bordi

# Momente Historike

---



**Shkurt 1999**

Themelohet e para kompani private e sigurimeve në Shqipëri - **SIGMA - Siguri e Madhe**

**Shtator 2004**

Sigma licensohet që të operojë në Kosovë.

**Shtator 2007**

Grupi më i madh i sigurimeve në Austri dhe CEE, Vienna Insurance Group, investon në tregun shqiptar të sigurimeve, duke bërë pjesë të saj kompaninë SIGMA

**Tetor 2014**


U bë bashkimi i kompanive Sigma dhe InterAlbanian.

**Maj 2016**

**Z. Qemal Disha** tërhiqet nga detyra si lider historik i kompanisë për t'ia kaluar menaxhimin **Z. Klaidi Çitozi**.

**Qershor 2023**

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë, vendosi rikthimin e emrit Sigma Vienna Insurance Group.



**SIGMA**  
FINANCO IMITACIÓ DESIGN

# Sigurohu online.

**Tijashë, Sigurimi, Sigurimi**

Esigurimi juaj, vetëm në 3 hapa

Përfundoni në ditë një ofertë kur e kushtojnë, atëherë krijoje sigurimin tuaj - kurrë e më parë dhe në detyrë.

**Shëndet në udhëtim**

**Sigurimi i pronës**

**Sigurimi i shtesës**


**TPA**

**Kamionet**

**Kufite**

Sigma 133 shërbimeve  
me numër "133" dhe "133"





## Vizioni

---

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si grupi lider në sigurime në Austri, Europën Qendrore dhe Lindore.



## Misioni

---

Ne jemi sinonim i stabilitetit dhe kompetencës përsa i përket mbrojtjes nga rreziku. Ne përdorim eksperiencën, njohuritë dhe diversitetin tonë për të qënë më pranë klientëve tanë. E konsiderojmë përgjegjësinë tonë që të mbrojmë ato që kanë vlerë për klientët tanë.



## Premtimi Ynë

---

Ne bëjmë të mundur që klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë sepse ne: Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!

# TREGU I SIGURIMEVE 2025

---

Gjatë vitit 2025, tregu shqiptar i sigurimeve vijoi trajektoren e tij pozitive të zhvillimit, duke regjistruar një rritje prej 10.54% krahasuar me vitin 2024. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 27,089,756 mijë lekë, me një rritje prej 2,583,977 mijë lekësh, ndërsa numri i kontratave të sigurimit u rrit me 5.07%, duke arritur në 1,676,640 kontrata.

Veprimtaria e sigurimeve Jo-Jetë vazhdoi të përfaqësojë segmentin dominues të tregut. Gjatë vitit 2025, primet e shkruara bruto në këtë segment arritën në 24,647,706 mijë lekë, ose 9.91% më shumë se një vit më parë. Paralelisht, numri i kontratave të sigurimit Jo-Jetë u rrit me 3.32%, duke arritur në 1,490,784 kontrata.

Në aspektin e dëmeve, gjatë vitit 2025 u paguan gjithsej 8,590,751 mijë lekë, ose 0.75% më pak krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, numri i dëmeve të likuiduara shënoi rritje, duke arritur në 75,996 raste, ose 2,514 dëme më shumë se në vitin paraardhës. Prej tyre, 72,538 dëme i përkisnin segmentit të sigurimeve Jo-Jetë.

Treguesit e vitit 2025 konfirmojnë vazhdimësinë e rritjes së tregut të sigurimeve, të mbështetur nga zgjerimi i bazës së klientëve dhe rritja e vëllimit të primeve. Njëkohësisht, stabiliteti i nivelit të dëmeve të paguara, i kombinuar me rritjen e numrit të dëmeve të trajtuara, reflekton përmirësimin e proceseve të administrimit të dëmeve dhe një menaxhim më efektiv të ekspozimit ndaj riskut. Këta zhvillime dëshmojnë një treg gjithnjë e më të konsoliduar, me ekuilibër më të mirë operacional dhe perspektivë të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm në vitet në vijim.



# Performanca e Sigma VIG në 2025

Viti 2025 rezultoi një vit konsolidimi dhe rritjeje të qëndrueshme për SIGMA Vienna Insurance Group, jo vetëm në nivel total të primeve të shkruara bruto, por edhe në segmentet kryesore të sigurimit, ku shoqëria arriti të përmirësojë ndjeshëm performancën krahasuar me vitin 2024.


Sipas të dhënave zyrtare të raportit statistikor vjetor të AMF, SIGMA VIG rriti primet e shkruara bruto nga rreth 2.82 miliardë lekë në vitin 2024 në mbi 3.13 miliardë lekë në vitin 2025, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 10.8%. Paralelisht, pjesa e tregut u zgjerua më tej në 12.69%.

Kompania, pjesë e grupit austriak të sigurimeve, Vienna Insurance Group, ka paguar gjithashtu mbi 1 miliardë lekë dëme, duke iu përgjigjur në kohë kërkesave të klientëve të saj për dëmshpërblime, si në rastet e sigurimeve motorike, ku rezultoi të jenë paguar pjesa më e madhe e dëmeve, 977 milionë lekë, me rritjen më të lartë në treg, 25.4% më shumë se në vitin 2024, ashtu edhe në kategoritë e tjera të sigurimit, si pronë e shëndet.


Në segmentin motorik, që mbetet boshti kryesor i aktivitetit për gjithë tregun e sigurimeve, SIGMA ka shënuar rritje të konsiderueshme të primeve. Në vitin 2025, primet e shkruara bruto nga sigurimet motorike arritën në rreth 2.6 miliardë lekë, nga 2.4 miliardë lekë në vitin 2024, ose rritje vjetore rreth 11.7%. Brenda këtij segmenti, sigurimi TPL vijon të mbajë peshën kryesore.



Rritje vjetore



Pjesa e tregut, reflekton pozicion konkurrues.



Rritje në sigurimet motorike

➡ **3.13 miliardë lekë**

prime të shkruara bruto në 2025. Krahasuar me 2.82 miliardë lekë në 2024.

➡ **mbi 1 miliard lekë**

dëme të paguara gjatë 2025.

# Performanca Sigma VIIG në 2025

Pozitive paraqitet edhe performanca në sigurimet e pronës, një segment me rëndësi strategjike për diversifikimin e portofolit. Në vitin 2025, SIGMA ka realizuar rreth 299 milionë lekë prime të shkruara bruto në sigurimet e pronës, nga rreth 260 milionë lekë në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 11%. Ky segment ka përfituar nga kërkesa në rritje për mbrojtje të aseteve, veçanërisht për risqe nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, duke ulur gradualisht varësinë nga sigurimi motorik.



**Rritje në sigurimin e pronës për dëmet nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore**

Ndërkohë, në segmentet e tjera jo-jetë, përfshirë aksidentet dhe shëndeti, sigurimet e përgjegjësi dhe risqeve të ndryshme, SIGMA ka ruajtur stabilitet dhe ka shënuar rritje të lehtë të primeve, duke kontribuar në balancimin e portofolit dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare krahasuar me vitin 2024.

Në tërësi, analiza sipas segmenteve tregon se rritja e SIGMA-s në vitin 2025 është mbështetur në disa produkte kyçe, me rritje të fortë në sigurimin motorik, zgjerim të ndjeshëm në sigurimet e pronës dhe zhvillim të qëndrueshëm në kategoritë e tjera të sigurimit. Krahasuar me vitin 2024, portofoli i vitit 2025 rezulton më i balancuar, më i diversifikuar dhe më rezistent ndaj riskut.

Kjo ecuri konfirmon se SIGMA Vienna Insurance Group po ndjek një strategji zhvillimi më të pjekur, duke kombinuar rritjen e volumit me përmirësimin e cilësisë së biznesit dhe forcimin e pozicionit konkurrues në tregun e sigurimeve.




**2.6 miliardë lekë**

primet e shkruara bruto nga sigurimet motorike

**299 milionë lekë**

prime të shkruara bruto në sigurimet e pronës





# Profili i Vienna Insurance Group

---

Vienna Insurance Group (VIG), me seli në Vjenë, është grupi lider i sigurimeve në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore (CEE). Mbi 50 kompani sigurimi dhe fonde pensionesh në 30 vende formojnë një Grup me traditë të gjatë, marka të forta dhe marrëdhënie të ngushta me klientët. Rreth 30,000 punonjës në VIG kujdesen për nevojat e përditshme të rreth 33 milionë klientëve.

## **Nga pionier në lider tregu në rajonin CEE**

VIG ishte një nga grupet e para evropiane të sigurimeve që u zgjerua në tregjet e Evropës Qendrore dhe Lindore pas rënies së Perdes së Hekurt në vitin 1989. Hap pas hapi, Grupi ndërtoi praninë e tij në tregje të reja dhe u pozicionua si numri një në rajon. Vienna Insurance Group e konsideron Evropën Qendrore dhe Lindore si tregun e saj kryesor dhe ndjek një strategji biznesi afatgjatë në tregjet bazë. Qëllimi është të zgjerojë në mënyrë të vazhdueshme pozicionin udhëheqës në rajonin CEE përmes rritjes afatgjatë dhe fitimprurëse.

## **Ekspertizë me përgjegjësi lokale**

Vienna Insurance Group ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh të personalizuar për mbrojtjen dhe parandalimin e riskut dhe përshtat vazhdimisht shërbimet e saj sipas kërkesave të një mjedisi dinamik. VIG ndjek një strategji multi-brand, duke mbështetur marka të konsoliduara në nivel rajonal dhe sipërmarrje lokale. Në fund të fundit, janë pikat e forta individuale të këtyre markave dhe ekspertiza e thellë e punonjësve që mundësojnë afërsinë me klientin dhe zhvillimin e suksesshëm të Grupit.

## **Financa të forta dhe vlerësim krediti**

Vienna Insurance Group ka marr vlerësim A+ me një perspektivë të qëndrueshme nga agjencia e mirënjohur ndërkombëtarisht, Standard&Poor's. Aksionet e VIG janë të listuara në bursat e Vjenës, Pragës dhe Budapestit. Wiener Städtische Versicherungsverein – një aksioner bazë i qëndrueshëm me fokus afatgjatë – zotëron 72% të aksioneve të VIG. Aksionet e tjera tregtohen në bursë.



Grupi i sigurimeve Vienna Insurance Group (VIG) ka regjistruar një vit shumë të suksesshëm financiar gjatë vitit 2025, duke shënuar rritje të fortë në primet e sigurimit dhe një zgjerim të ndjeshëm të fitimit.

Sipas rezultateve paraprake të publikuara më 12 mars 2026, vëllimi i primeve bruto të shkruara arriti në 16.3 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 7.1% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga shërbimet e sigurimit u rritën në 13.2 miliardë euro, me një rritje prej 8.7%, ndërsa fitimi para tatimit arriti në 1.16 miliardë euro, ose 31.7% më shumë se në vitin 2024.

Gjatë vitit 2025, Vienna Insurance Group arriti për herë të parë në historinë e saj të kalojë pragun e një miliardë eurove fitim para tatimit, duke arritur në 1.161 miliardë euro.

Rritja e primeve gjatë vitit 2025 është mbështetur nga performanca pozitive në të gjitha segmentet dhe linjat e biznesit. VIG operon prej shumë vitesh edhe në Shqipëri, përmes shoqërisë Sigma Vienna Insurance Group, e cila pati gjithashtu një performancë shumë të mirë në 2025, me rritje mbi mesataren e tregut të sigurimeve.

→ **296%**

Grupi ruajti një pozicion shumë të fortë kapitali, me një tregues mjaftueshmërie 296%

→ **1.161 MILIARDË EURO**

Gjatë vitit 2025, Vienna Insurance Group arriti për herë të parë në historinë e saj të kalojë pragun e një miliardë eurove fitim para tatimit



Status: January 2026

We are **Number 1**  
in Central and Eastern Europe

# Sigma VIIG në shifra 2025

## Aktivet

Mbi 124 mln EURO

## Kapitali

Mbi 20 mln EURO

Gjatë vitit 2025, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit rezultoi në nivelin 278%, duke tejkalar ndjeshëm kërkesat rregullatore të përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Ky nivel konfirmon qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, aftësinë e saj për të përballuar ekspozimet ndaj riskut dhe ruajtjen e një pozicioni të fortë kapitali në mbështetje të zhvillimit të aktivitetit.

Në të njëjtën kohë, treguesi i aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike arriti në 154%, duke reflektuar një strukturë të shëndoshë financiare dhe një nivel të lartë mbulimi të detyrimeve teknike. Ky treguesi evidencon aftësinë e shoqërisë për të garantuar përmbushjen në kohë të detyrimeve ndaj të siguruarve, në përputhje me standardet prudenciale dhe kërkesat rregullatore në fuqi.

## Të ardhura nga primet

33 milion Euro

## Dëme të paguara

11.5 milion euro

## Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

278 %

## Treguesi i Aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike

154 %

## Provigjionet teknike

46 milion euro

## Pjesa e Tregut

12.69 %

## Great Place to Work

### Vienna Insurance Group certifikohet si "Great Place to Work"

Vienna Insurance Group (VIG) u vlerësua me certifikimin ndërkombëtar "Great Place to Work", një nga standardet më të njohura në nivel global për kulturën organizative dhe përvojën e punonjësve në vendin e punës.

Ky vlerësim u bazua në një anketim anonim të zhvilluar nga organizata e pavarur Great Place To Work®, ku punonjësit e VIG vlerësuan kulturën organizative në pesë dimensione kryesore: besueshmërinë, respektin, drejtësinë, krenarinë për organizatën dhe frymën e bashkëpunimit.

Rezultatet treguan se 83% e punonjësve e konsiderojnë VIG një vend të shkëlqyer pune, duke reflektuar angazhimin e Grupit për krijimin e një mjedisi pune të bazuar në besim, respekt dhe zhvillim profesional. Në të njëjtën kohë, një numër i konsiderueshëm i shoqërive të Grupit morën pjesë në këtë proces dhe u certifikuan gjithashtu me të njëjtin standard.

Vlerësimet më pozitive u regjistruan në fushat e bashkëpunimit ndërmjet ekipeve, balancës mes jetës profesionale dhe personale, diversitetit, kulturës së hapur organizative dhe lidërshiptit.

Përmes programit të qëndrueshmërisë "VIG 25", Vienna Insurance Group promovon barazinë e mundësive, diversitetin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të punonjësve, duke i konsideruar ata një nga shtyllat kryesore të strategjisë së saj të qëndrueshmërisë. Certifikimi "Great Place to Work" përfaqëson një konfirmim të këtij angazhimi dhe të kulturës organizative që Grupi ndërton në të gjitha shoqëritë e tij.

Vlerësimet më pozitive u regjistruan në fushat e bashkëpunimit ndërmjet ekipeve, balancës mes jetës profesionale dhe personale, diversitetit, kulturës së hapur organizative dhe lidërshiptit.

Përmes programit të qëndrueshmërisë "VIG 25", Vienna Insurance Group promovon barazinë e mundësive, diversitetin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të punonjësve, duke i konsideruar ata një nga shtyllat kryesore të strategjisë së saj të qëndrueshmërisë. Certifikimi "Great Place to Work" përfaqëson një konfirmim të këtij angazhimi dhe të kulturës organizative që Grupi ndërton në të gjitha shoqëritë e tij.



## Si mund të nxitet tregu i sigurimeve

Intervistë me z. Klaidi Çitozi, CEO i Sigma Vienna Insurance Group  
Revista Monitor, 10.10.2025

Megjithëse ekonomia shqiptare ka njohur rritje dhe janë të pranishme grupe të fuqishme ndërkombëtare, tregu i sigurimeve vijon të mbetet ndër më të pazhvilluarit në Europë.

Me më pak se 1% të PBB-së, ky treg mbështetet kryesisht te sigurimet e detyrueshme, ndërsa sigurimet vullnetare kanë mbetur në hije.

Në një intervistë për "Monitor", Klaidi Çitozi, CEO i "Sigma Vienna Insurance Group", shpjegon se kombinimi i të ardhurave të ulëta, kulturës së kufizuar të sigurimit dhe mungesës së nxitësve për produkte të reja e ka mbajtur sektorin të pazhvilluar.

Ai nënvizon se vetëm nëpërmjet edukimit financiar, inovacionit dhe bashkëpunimit më të gjerë mes institucioneve dhe kompanive private, tregu mund të afrohet me standardet rajonale dhe europiane.

Sipas tij, rritja e sigurimeve vullnetare kërkon investim në edukimin e qytetarëve, përmirësim të përvojës së klientit dhe zhvillim produkte të reja që adresojnë nevojat reale të individëve dhe bizneseve.



### Z. Çitozi, si do ta vlerësonit ecurinë e "Sigma"-s gjatë vitit 2024 dhe pjesën e parë të vitit 2025?

Viti 2024 ishte pozitiv për "Sigma VIG", në një treg që megjithatë mbeti i ngarkuar me sfida. Ne patëm një rritje të primeve mbi mesataren e tregut duke konsoliduar pozitat tona tradicionale, jo vetëm në segmentin e sigurimeve motorike, por edhe në sigurimet e pronës, një segment të cilin e konsiderojmë strategjik për zhvillimin afatgjatë. Në vitin 2025, tendenca ka vijuar pozitive: rritja e primeve të shkruara bruto është rreth 10%, ndërkohë që tregu në tërësi ka lëvizur me një ritëm më të ulët. Kjo na jep sinjalin se strategjia jonë është e qëndrueshme dhe po na diferencon nga konkurrenca.

Një element tjetër i rëndësishëm është kapitali njerëzor. "Sigma" është në mënyrë të vazhdueshme në proces rekrutimi për të tërhequr staf cilësor dhe për të përforcuar ekipet tona në të gjitha nivelet. Ne i trajnojmë punonjësit jo vetëm për aftësitë teknike që kërkon industria e sigurimeve, por edhe për zhvillimin e soft skills si komunikimi, menaxhimi i marrëdhënieve me klientët dhe puna në ekip, të cilat janë po aq të rëndësishme për të ofruar një shërbim të shkëlqyer. Ky kombinim i ekspertizës teknike me aftësitë ndërpersonale është një nga faktorët që na ka lejuar të ruajmë performancën e lartë dhe të forcojmë besimin e klientëve.

## **Pse tregu shqiptar i sigurimeve vijon të mbetet ndër më të ulët në Europë, me më pak se 1% të PBB-së?**

Në Shqipëri, raporti i primeve të sigurimit të jo-jetës ndaj PBB-së është rreth 0.9%, ndërkohë që mesatarja europiane për totalin e primeve të sigurimeve është mbi 6%. Ky diferencim i madh lidhet me disa faktorë. Së pari, niveli i të ardhurave për frymë është ende i ulët krahasuar me vendet e BE-së. Së dyti, kultura e sigurimit është e kufizuar. Qytetarët shpesh e shohin sigurimin si shpenzim dhe jo si instrument për stabilitet afatgjatë. Një tjetër element ka të bëjë me strukturën e tregut, i cili historikisht është mbështetur kryesisht te sigurimet e detyrueshme.

Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe zhvillimi i pamjaftueshëm i sektorit më të gjerë financiar në vend, i cili ka kufizuar qasjen dhe përdorimin e instrumenteve financiare moderne, përfshirë sigurimet. Studime të ndryshme tregojnë se oferta e kufizuar dhe qasja jo e plotë ndaj shërbimeve financiare krijojnë barriera serioze për zgjerimin e tregut të sigurimeve. Ky kombinim faktorësh shpjegon pse Shqipëria mbetet ende në nivele shumë më të ulëta krahasuar me rajonin dhe Europën, pavarësisht pranisë së kompanive ndërkombëtare.

Me rritjen e standardeve të jetesës gjatë 7 – 8 viteve të fundit, qytetarët po bëhen gjithnjë e më kërkues për siguri dhe stabilitet. Ky progres duhet të shoqërohet edhe me zgjedhjen e instrumenteve financiare të përshtatshme, që jo vetëm mbrojnë atë që është arritur, por edhe garantojnë vazhdimësinë e këtij standardi për të ardhmen.

## **Si e shpjegoni faktin që hyrja e kompanive të huaja nuk arriti të japë impuls të fortë për diversifikimin e tregut?**

Hyrja e grupeve ndërkombëtare ka qenë një zhvillim i rëndësishëm, sepse ka sjellë standarde më të larta shërbimi, një gamë më të gjerë produktesh dhe transparencë më të madhe ndaj publikut. Megjithatë, kjo nuk ka mjaftuar për të sjellë transformimin e pritshëm në treg. Arsytet janë të shumta. Tregu shqiptar është ende i vogël në volum, dhe produktet inovative kërkojnë një bazë të gjerë klientësh dhe prime më të mëdha që të jenë të qëndrueshme financiarisht. Gjithashtu, situata nuk ka qenë gjithnjë e favorshme për zhvillimin e produkteve të reja. Shpeshherë mungojnë stimujt për sigurimet vullnetare, ndërkohë që sigurimet e detyrueshme dominojnë portofolin e tregut. Një faktor tjetër është edhe mentaliteti i qytetarëve, të cilët shpesh presin që në rast fatkeqësisht natyrore apo emergjencash të mëdha zgjidhja të vijë nga qeveria. Ky perceptim është ushqyer nga tradita prej së cilës vijmë. Në praktikë, asnjë buxhet shtetëror nuk mund të përballojë i vetëm kostot e larta të katastrofave. Për këtë arsye, individët dhe bizneset duhet të ndërgjegjësohen se zgjidhja afatgjatë nuk është pritja ndaj ndihmës publike, por krijimi i pavarësisë së tyre financiare përmes sigurimeve.

Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe zhvillimi i pamjaftueshëm i sektorit më të gjerë financiar në vend, i cili ka kufizuar qasjen dhe përdorimin e instrumenteve financiare moderne, përfshirë sigurimet. Studime të ndryshme tregojnë se oferta e kufizuar dhe qasja jo e plotë ndaj shërbimeve financiare krijojnë barriera serioze për zgjerimin e tregut të sigurimeve. Ky kombinim faktorësh shpjegon pse Shqipëria mbetet ende në nivele shumë më të ulëta krahasuar me rajonin dhe Europën, pavarësisht pranisë së kompanive ndërkombëtare.

Me rritjen e standardeve të jetesës gjatë 7 – 8 viteve të fundit, qytetarët po bëhen gjithnjë e më kërkues për siguri dhe stabilitet. Ky progres duhet të shoqërohet edhe me zgjedhjen e instrumenteve financiare të përshtatshme, që jo vetëm mbrojnë atë që është arritur, por edhe garantojnë vazhdimësinë e këtij standardi për të ardhmen.

## **Si e shpjegoni faktin që hyrja e kompanive të huaja nuk arriti të japë impuls të fortë për diversifikimin e tregut?**

Hyrja e grupeve ndërkombëtare ka qenë një zhvillim i rëndësishëm, sepse ka sjellë standarde më të larta shërbimi, një gamë më të gjerë produktesh dhe transparencë më të madhe ndaj publikut. Megjithatë, kjo nuk ka mjaftuar për të sjellë transformimin e pritshëm në treg. Arsyet janë të shumta. Tregu shqiptar është ende i vogël në volum, dhe produktet inovative kërkojnë një bazë të gjerë klientësh dhe prime më të mëdha që të jenë të qëndrueshme financiarisht. Gjithashtu, situata nuk ka qenë gjithnjë e favorshme për zhvillimin e produkteve të reja. Shpeshherë mungojnë stimujt për sigurimet vullnetare, ndërkohë që sigurimet e detyrueshme dominojnë portofolin e tregut. Një faktor tjetër është edhe mentaliteti i qytetarëve, të cilët shpesh presin që në rast fatkeqësisht natyrore apo emergjencash të mëdha zgjidhja të vijë nga qeveria. Ky perceptim është ushqyer nga tradita prej së cilës vijmë. Në praktikë, asnjë buxhet shtetëror nuk mund të përballojë i vetëm kostot e larta të katastrofave. Për këtë arsye, individët dhe bizneset duhet të ndërgjegjësohen se zgjidhja afatgjatë nuk është pritja ndaj ndihmës publike, por krijimi i pavarësisë së tyre financiare përmes sigurimeve.

Vetëm kështu garantohet një mbrojtje reale dhe e qëndrueshme, e cila nuk varet nga vendimmarrjet apo mundësitë e momentit. Megjithatë, për "Sigma VIG" kjo ka qenë një mundësi. Si pjesë e "Vienna Insurance Group" – një prej grupeve më të mëdha në Europën Qendrore dhe Lindore – ne kemi pasur mundësinë të sjellim praktikën më të mira ndërkombëtare, të forcojmë kapitalin dhe të ndërtojmë një model biznesi afatgjatë. VIG e sheh Shqipërinë si një treg me potencial të madh në të ardhmen. Pavarësisht sfidave të sotme, rritja ekonomike dhe ndërgjegjësimi gradual financiar krijojnë bazën për një zhvillim të qëndrueshëm. Për këtë arsye, mbështetja e grupit na ka dhënë avantazhin e qartë për të qenë një faktor i rëndësishëm në transformimin e tregut vendas.

## **Tregu është ende i varur nga sigurimet e detyrueshme. Çfarë duhet bërë për të rritur peshën e sigurimeve vullnetare?**

Është e vërtetë që rreth 70% e tregut shqiptar dominohet ende nga sigurimet e detyrueshme, kryesisht ato motorike. Për të rritur peshën e sigurimeve vullnetare, duhet punuar në disa drejtime të ndërthurura:

**-Edukimi financiar i klientit.** Sigurimi shpesh perceptohet thjesht si një shpenzim i imponuar, ndërkohë që në thelb është një instrument i domosdoshëm për stabilitetin financiar të individëve dhe bizneseve. Qytetarët duhet ta shohin sigurimin jo si kosto, por si një investim për të ardhmen, një mënyrë për të mbrojtur standardin e jetesës dhe për të siguruar vazhdimësinë e tij edhe në momente të vështira. Po ashtu, bizneset, qofshin korporata apo SME, duhet ta kuptojnë se sigurimi është një mekanizëm që u mbron kapitalin, asetet dhe kapitalin njerëzor.

**-Shërbimi ndaj klientit.** Përvoja e klientit është vendimtare. Një klient që merr dëmshpërblimin në kohë dhe në mënyrë transparente fiton besim te kompania dhe e shikon sigurimin si partner të aktivitetit të tij.

Për këtë arsye, kompanitë duhet të investojnë në procese të shpejta dhe të thjeshta për menaxhimin e dëmeve. "Sigma" ka bërë hapa konkretë në këtë drejtim, duke reduktuar kohën mesatare të dëmshpërblimeve dhe duke forcuar komunikimin e hapur me klientët.

**-Zhvillimi i produkteve të reja.** Sigurimet vullnetare mund të rriten vetëm nëse iu përgjigjen nevojave reale të tregut. Kjo do të thotë më shumë lloje produktesh dhe paketa të kombinuara për familjet, si dhe mbulim për rreziqe të reja që lidhen me ndryshimet klimatike apo aktivitetin digjital.

**-Mbështetje institucionale dhe kuadër ligjor nxitës.** Përveç përpjekjeve të vetë kompanive, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe qeveria, nëpërmjet politikave stimuluuese dhe nismave ligjore që synojnë të rrisin aksesueshmërinë dhe atraktivitetin e sigurimeve për qytetarët dhe bizneset.

Në këtë proces, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka qenë një faktor kyç. Nëpërmjet reformave të vazhdueshme dhe forcimit të kuadrit rregullator, AMF ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në treg.

Sot, përlllogaritja e dëmeve është e aksesueshme publikisht në faqen e AMF-së, çdo individ mund të llogarisë vetë primin e sigurimit, ndërsa koha e trajtimit të dëmeve është ndjeshëm e shkurtuar, falë standardeve të reja të vendosura.

Një tjetër dëshmi e këtij progresi është organizimi për herë të parë në Shqipëri i Konferencës Vjetore Globale të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve 2025, një nismë që e pozicionon AMF-në si aktor aktiv jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe rajonal, duke nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira dhe harmonizimin me standardet europiane.

Ky organizim vjen në një moment të rëndësishëm për tregun shqiptar të sigurimeve, duke mbështetur proceset reformuese dhe integruuese, me synim forcimin e institucioneve dhe të sektorit financiar, në përputhje me standardet europiane.

Nëse këto drejtime ecin paralelisht, atëherë pesha e sigurimeve vullnetare në Shqipëri do të mund të afrohej me nivelin e rajonit dhe të BE-së.

### **Si po ndikojnë ndryshimet klimatike në tregun e sigurimeve?**

Ndryshimet klimatike kanë sjellë një rritje të dukshme të rreziqeve natyrore. Përmbytjet, stuhitë apo tërmetet janë bërë më të shpeshta dhe kjo ka dy efekte: rrit kërkesën për sigurime, por edhe rrit barrën mbi kompanitë.

Për "Sigma VIG", kjo është një arsye shtesë për të qenë proaktivë. Po zhvillojmë produkte që adresojnë më mirë këto rreziqe dhe po llojmë që të rritet ndërgjegjësimi publik. Shqipëria ka nevojë për një strategji kombëtare të menaxhimit të riskut klimatik, ku sigurimet të jenë pjesë qendrore.

### **Së fundmi është publikuar drafti i sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet. Si e vlerësoni këtë nismë?**

Projektligji për sigurimin e detyrueshëm nga tërmetet është një hap i rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit dhe për mbrojtjen e qytetarëve.

Shqipëria është një nga vendet me risk sizmik më të lartë në rajon dhe ngjarjet e vitit 2019 treguan qartë se dëmet financiare mund të jenë kolosale e të papërbalueshme vetëm nga buxheti i shtetit.

Megjithatë, për të qenë një skemë funksionale dhe e qëndrueshme, është thelbësore përfshirja aktive e shoqërive të sigurimit.

Kjo për disa arsye, ndër të cilat infrastruktura ekzistuese e kompanive të sigurimit. Ato kanë rrjete shitjeje me agjentë të licencuar, sisteme IT dhe burime njerëzore të specializuara për administrimin e produkteve dhe dëmeve.

Përvoja ndërkombëtare tregon qartë se bashkëpunimi publik-privat është çelësi i suksesit.

Modele si ai francez CATNAT, por edhe praktikrat në vende si Gjermania, Italia apo Kroacia, tregojnë se shteti ofron garanci dhe instrumente në rast katastrofash të mëdha, ndërsa kompanitë private mbeten mekanizmi kryesor për shpërndarjen e riskut, shërbimin ndaj qytetarëve dhe administrimin e dëmeve.

Një model i integruar ku shteti ofron garanci dhe subvencionim për shtresat në nevojë, ndërsa kompanitë private menaxhojnë shitjen, vlerësimin e pagesën e dëmeve dhe risigurimin, do të ishte më i qëndrueshëm dhe më transparent.

Nëse krijohet kjo sinergji midis shtetit dhe sektorit privat, skema do të fitojë besimin e qytetarëve, do të jetë e përbalueshme për konsumatorin, e qëndrueshme financiarisht dhe do të garantojë që pas çdo fatkeqësie, individët dhe bizneset të kenë një mekanizëm real për t'u ringritur dhe për të vijuar jetën dhe aktivitetin normalisht.



**SIGURIM I PLOTË**

## **Klienti është boshti rreth të cilit ndërtohet çdo vendim**

Në një treg të vogël dhe të fragmentuar si ai shqiptar, të ruash standardin europian në sigurime kërkon jo vetëm përkushtim, por vizion dhe fleksibilitet të vazhdueshëm.

Në këtë intervistë, **z. Ervin Rali, Anëtar Bordi dhe Drejtor i Shitjeve në Sigma VIG**, ndan përvojat, sfidat dhe ambiciet që formësojnë filozofinë e shitjeve dhe raportit me klientin në një nga kompanitë më inovative të tregut të sigurimeve.



### **Z. Rali, cili është roli i klientit në filozofinë e biznesit të Sigma VIG?**

Klienti nuk është thjesht një përfitues i shërbimit tonë – ai është qëllimi ynë. Qoftë individ apo biznes, ne e shohim secilin klient si një partner strategjik, të cilit i ofrojmë zgjidhje të personalizuar për nevojat e tij të sigurimit. Në thelb, ne nuk “shesim” produkte – ne ndërtojmë besim. Dhe kjo nis nga mirëkuptimi, vijon me zgjidhje inteligjente dhe përmbillet me trajtim korrekt dhe të menjëhershëm në momentin kur ndodh dëmi. Transparenca, përgjegjshmëria dhe koha e reagimit janë themelet mbi të cilat ndërtojmë këtë marrëdhënie.

### **Sa e sfidueshme është të ruani standardet europiane në një treg që ende është i fokusuar kryesisht tek sigurimi i detyrueshëm motorik (TPL)?**

Është një sfidë reale, por njëkohësisht edhe një mundësi. Tregu shqiptar mbetet i dominuar nga sigurimet TPL, por ne nuk e kemi parë kurrë këtë si kufizim. Ne kemi zgjedhur të vendosim standarde të reja për veten, edhe kur tregu ende nuk i kërkon. Si pjesë e grupit austriak Vienna Insurance Group, ne kemi për detyrë të sjellim në treg jo vetëm produkte të sigurta, por edhe mënyra të reja të të menduarit për sigurimet – me vizion afatgjatë dhe fokus në mbrojtjen reale të individit dhe biznesit.

### **Cilat janë risitë që po sjell Sigma VIG në mënyrën e të bërit shitje?**

Ne po investojmë fort në digjitalizim – që nga ofertimi i shpejtë online, te nënshkrimi elektronik dhe shitjet përmes platformave digjitale. Jemi duke zgjeruar kanalet tona të shitjes për të qenë aty ku është klienti – në zyrë, në internet, në telefon, në rrugë. Por pavarësisht gjithë këtyre inovacioneve, ne besojmë se sigurimet mbeten një marrëdhënie besimi. Dhe kjo marrëdhënie kërkon një njeri që të dëgjojë, të kuptojë, të këshillojë. Prandaj, punonjësi i shitjeve do të jetë gjithmonë në zemër të strategjisë sonë.

### **Si i shihni zhvillimet në të ardhmen e afërt?**

Ne po përgatitemi për një klient gjithnjë e më të informuar, më kërkues dhe më të ndjeshëm ndaj përvojës që merr. Shitjet nuk do jenë më vetëm transaksione – ato do jenë eksperiencë. Për këtë arsye, ne po punojmë në një strategji të balancuar mes kanaleve fizike dhe digjitale, duke rritur kompetencat e forcës sonë shitëse, duke integruar të dhënat në mënyrë më inteligjente dhe duke krijuar produkte të ndërtuara mbi jetën reale të klientit.

### **Në fund, cili është mesazhi juaj për klientët dhe për tregun shqiptar të sigurimeve?**

Sigurimet nuk janë luks – ato janë një domosdoshmëri për stabilitetin personal dhe financiar. Te Sigma VIG, ne nuk ofrojmë thjesht polica – ne ofrojmë garanci, siguri dhe një partner që është aty kur më së shumti nevojitet. Vizioni ynë është i qartë: të jemi zgjedhja e parë për klientin shqiptar, jo vetëm për shkak të primit të sigurimit apo emrit, por sepse e dëshmojmë veten çdo ditë, me profesionalizëm, kujdes dhe korrektësi.

## **Sigurimi që Vepron: Sigma VIG garanton dëmshpërblime të drejta dhe në kohë.**

Dëmshpërblimi i drejtë dhe në kohë është thelbi i marrëdhënies mes një kompanie sigurimi dhe klientit të saj. Sigma VIG ka ndërtuar reputacionin e vet pikërisht mbi këtë parim, duke vendosur klientin në qendër të çdo procesi. Në këtë intervistë, z. Artan Pjetërnikaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve, shpjegon se si kompania garanton trajtim të drejtë dhe profesional të dëmeve, si dhe përkushtimin ndaj një shërbimi transparent dhe njerëzor.

**Z. Pjetërnikaj, ju jeni pjesë e Bordit të Drejtorëve në Sigma VIG dhe mbikëqyrni ndër të tjera departamentin ligjor dhe atë të dëmeve. Si e shihni ju përgjegjësinë e një kompanie sigurimesh në këtë aspekt në Shqipëri?**



Roli i një shoqërie sigurimi nuk është thjesht të ofrojë dhe të shesë produkte sigurimi, por edhe të garantojë që kur ndodh një ngjarje e padëshiruar, klienti të ndjejë realisht mbështetjen e sistemit të sigurimeve nëpërmjet dëmshpërblimit. Kjo kërkon një proces të drejtë, transparent dhe të shpejtë të dëmshpërblimeve, si dhe një qasje ligjore që ruan barazinë midis të drejtave të klientit dhe detyrimeve të kompanisë. Në këtë drejtim, Sigma VIG ka ndërtuar një kulturë korporative ku integriteti dhe përgjegjësia janë thelbësore në përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore dhe njëkohësisht vënien në qendër të këtij procesi të subjekteve të siguruar.

**Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen kompanitë e sigurimeve kur vjen puna te procesi i dëmshpërblimeve në tregun shqiptar?**

Sfidat janë të shumta, por 3 (tre) prej tyre janë më kritike:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i procedurave për trajtimin e dëmeve, me fokus në uljen e vazhdueshme të kohës së trajtimit të tyre;
- Perceptimi publik shpesh i ndikuar jo pozitivisht nga raste të izoluara, jo detyrimisht të lidhura me shoqërinë, por me tregun e sigurimeve si një i tërë;
- Vonesat që burojnë nga faktorë të jashtëm si institucionet që lëshojnë akte të nevojshme për trajtimin e dëmeve.

Për të adresuar disa nga këto probleme, shoqëria jonë po investon krahas të tjerave dhe në digjitalizimin e proceseve dhe në përmirësimin e aftësive të stafit me trajnime të vazhdueshme, për të garantuar menaxhim të përsheptuar dhe sa më të standartizuar të dëmeve.

**A ka përparime konkrete në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe harmonizimit me direktivat e BE për sigurimet, sidomos për dëmet?**

Po, ka një zhvillim të dukshëm, veçanërisht pas vitit 2021, ku janë ndërmarrë hapa konkretë për të përputhur legjislacionin kombëtar me atë të BE-së. Ligji 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", ka realizuar një përafrim të pjesshëm me Direktivën 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Megjithatë, procesi i përafrimit të plotë me Direktivën Evropiane do të realizohet shpejt nga legjislatori, duke pasur parasysh këtu aspiratat dhe procesin e vendit tonë për integrimin e plotë dhe anëtarësimin në BE. Sigma VIG, ka kontribuar dhe do të kontribuojë në këtë proces me ekspertizën e saj, përmes Shoqatës së Siguruesve.

## **Sigma VIG është e njohur si një kompani që paguan shpejt dëmet që u takojnë klientëve. Si është arritur kjo dhe çfarë mekanizmesh keni në vend për të garantuar transparencë dhe shpejtësi?**

Ky reputacion është ndërtuar mbi punë të strukturuar ndër vite. Së pari, kemi vendosur objektiva të qarta për kohën e trajtimit të dëmeve. Në shumë raste, pagesa kryhet brenda pak ditësh nga përfundimi i dokumentacionit. Së dyti, kemi automatizuar pjesë të procesit dhe kemi ndërtuar një sistem të brendshëm të kontrollit cilësor për çdo dosje dëmi. Dhe më e rëndësishmja, kemi një kulturë brenda kompanisë që e trajton klientin si partner, jo si palë kundërshtare.


## **Në ç'mënyrë bashkëpunon departamenti ligjor me atë të dëmeve, për të mbrojtur njëkohësisht interesin e klientit dhe integritetin e kompanisë?**

Është një bashkëpunim strategjik në kuadër të të bërit biznes dhe njëkohësisht ligjor në aspekt të përmbushjes së detyrimeve. Qasja jonë ligjore nuk është thjesht mbrojtëse, por edhe proaktive. Analizojmë risqet, ofrojmë interpretim të drejtë të kontratave dhe synojmë zgjidhje të drejtë. Departamenti ligjor bashkëpunon ngushtësisht me kolegët e dëmeve për të siguruar që zgjidhja ligjore e çdo rasti është e balancuar dhe në përputhje me standardet e kompanisë dhe aktet rregullative në fuqi. Ky bashkëpunim ka eliminuar burokracinë e panevojshme dhe ka përshpejtuar procesin e dëmshpërblimeve.

## **Cili është mesazhi juaj për klientët dhe institucionet publike lidhur me rëndësinë e një procesi të drejtë dhe të shpejtë dëmshpërblimi?**

Sigurimi nuk është thjesht dhe vetëm një detyrim ligjor apo një produkt financiar, është një kontratë besimi. Kur ndodh një dëm tek të siguarit, ajo që vlen është dëmshpërblimi në kohë, trajtimi me korrektësi dhe me përgjegjshmëri që buron nga përgjegjësia. Në thelb të çdo dëmi që trajtojmë, qëndron një premtim: ai që, Sigma VIG i qëndron besnike kontratës me klientin. Si pjesë e Vienna Insurance Group, një nga grupet më të mëdha dhe më të qëndrueshme të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, ne operojmë mbi standarde të larta transparence dhe korrektësie.

Ne jemi një partner financiar i besueshëm, që mban premtimin dhe përmbush çdo detyrim të marrë përsipër. Pavarësisht kompleksitetit dhe veçantisë së çdo rasti, në çdo proces dëmshpërblimi qëndron një filozofi e thjeshtë: klienti meriton një trajtim ligjor, të drejtë, të shpejtë dhe njerëzor. Kjo është arsyeja pse gjithnjë e më shumë individë dhe biznese në Shqipëri i besojnë kompanisë Sigma, sepse ne nuk i shmangemi përgjegjësisë, por e përqafojmë atë me profesionalizëm dhe integritet.



## **Albion Nasaj: Risku nuk është frikë, por mundësi për besim dhe zhvillim**

Në një kohë kur tregjet po përballen me pasiguri të shumta – nga ndryshimet klimatike e deri te sfidat kibernetike – menaxhimi i riskut është kthyer në një nga funksionet më strategjike për kompanitë e sigurimeve. SIGMA VIG, pjesë e Vienna Insurance Group, është një prej aktorëve kryesorë në tregun shqiptar, me një qasje proaktive dhe afatgjatë ndaj riskut.

Në këtë intervistë, z. Albion Nasaj, Drejtor i Riskut në SIGMA VIG, ndan vizionin e tij për mënyrën se si risku duhet të trajtohet – jo thjesht si kërcënim, por si mundësi për të ndërtuar qëndrueshmëri, besim dhe zhvillim. Ai flet për sfidat e tregut shqiptar, ndikimin e digjitalizimit, rolin e grupit ndërkombëtar dhe përvojat konkrete që kanë formësuar qasjen e kompanisë ndaj riskut.



### **Z.Nasaj, ju drejtoni një nga funksionet më kritike në një kompani sigurimesh – menaxhimin e riskut.**

#### **Si e përkufizoni ju riskun në kontekstin e SIGMA VIG?**

Në industrinë tonë, risku nuk është thjesht një kërcënim – është një mundësi për të qenë më të kujdesshëm, më strategjikë dhe më të qëndrueshëm. Për SIGMA VIG, risku përkufizohet si çdo faktor i brendshëm apo i jashtëm që mund të ndikojë në aftësinë tonë për të përmbushur premtimet ndaj klientëve dhe aksionerëve. Menaxhimi efektiv i tij është një mjet balancues midis mbrojtjes së kompanisë dhe rritjes së saj.

### **Cilat janë risqet kryesore me të cilat përballlet një kompani sigurimesh në tregun shqiptar?**

Tregu shqiptar është dinamik, me sfida që variojnë nga frekuenca e dëmeve në linjat motorike, deri te përthithja e rregulloreve të reja evropiane. Në shumë linja të industrisë në Shqipëri, mungesa e standarteve në operim sjell një variancë më të madhe në vlerësimin e riskut. Në veçanti, shohim rritje të riskut klimatik, riskut operacional për shkak të digjitalizimit të shpejtë, dhe gjithashtu ekspozimin ndaj riskut reputacional në një treg me transparencë gjithnjë në rritje.

### **Si funksionon procesi i menaxhimit të riskut brenda SIGMA VIG?**

Ne e trajtojmë menaxhimin e riskut si një proces të integruar në çdo nivel të kompanisë. Fillojmë me identifikimin, më pas analizën, vlerësimin dhe përgatitjen e planit zbatues. Kemi një praktikë të zgjeruar kontrollesh dhe përdorim modele statistikore dhe stress tests për të simuluar ndikimet e mundshme. Ajo që e bën diferencën është bashkëpunimi ndërmjet departamentave. Risku nuk është përgjegjësi vetëm e një departamenti, por e të gjithëve.

### **Si ndikon digjitalizimi në profilin e riskut të një kompanie sigurimi sot?**

Digjitalizimi ka transformuar mënyrën si operojmë, por gjithashtu ka krijuar një spektrum të ri rreziqesh – nga sulmet kibernetike deri te ndërprerjet e papritura të sistemeve. SIGMA VIG është duke investuar shumë në sigurinë kibernetike, trajnimin e stafit dhe auditime të vazhdueshme për të minimizuar këto risqe. Nga ana tjetër, teknologjia na ndihmon të identifikojmë dhe menaxhojmë më mirë riskun në kohë reale.

## **A mund të na tregoni një rast konkret kur një vendimmarrje në lidhje me riskun rezultoi kritike për kompaninë?**

Sigurisht. Gjatë përmbytjeve apo tërmetejeve që kanë ndodhur vitet e fundit, falë sistemit tonë të vlerësimit të riskut klimatik, kishim reduktuar ekspozimin e kompanisë duke përzgjedhur me kujdes mbulimin në risigurim ndaj katastrofave natyrore, sigurisht kjo meritë dhe e grupit ndërkombëtar në të cilin bëjme pjesë. Kjo na lejoi të reagonim menjëherë, të dëmshpërblenim klientët në kohë rekord dhe të ruanim stabilitetin financiar.

## **SIGMA VIG është pjesë e Vienna Insurance Group (VIG), një nga grupet më të mëdha të sigurimeve në Europën Qendrore dhe Lindore. Si ndikon kjo në mënyrën si menaxhoni riskun në tregun shqiptar?**

Fakti që jemi pjesë e VIG, përbën një avantazh strategjik. Ne operojmë me një pavarësi të plotë vendimmarrëse në tregun lokal, por me një mbështetje të pakrahasueshme financiare dhe ekspertizë ndërkombëtare. Kjo do të thotë se kemi akses në praktikat më të mira evropiane për menaxhimin e riskut, modele të avancuara statistikore, si dhe kapacitete të forta rikuperimi në rast krizash. Në një treg ku shumë kompani operojnë duke përbushur detyrimet minimale ligjore, ne kemi luksin të ndërtojmë për të ardhmen, jo vetëm t'ia dalim në të tashmen.

## **Si e shikoni të ardhmen e funksionit të riskut në industrinë e sigurimeve?**

E ardhmja kërkon më shumë parashikim, jo vetëm reagim. Risku do të menaxhohet gjithnjë e më shumë përmes inteligjencës artificiale, analizës së të dhënave të mëdha, dhe bashkëpunimit ndërsektorial. Por në thelb, do të mbetet një funksion njerëzor – sepse interpretimi dhe vendimmarrja kërkojnë gjykim profesional dhe integritet. Në SIGMA VIG, po ndërtojmë këtë balancë midis teknologjisë dhe përvojës njerëzore.

## **Një mesazh për të rinjtë që duan të ndjekin një karrierë në menaxhimin e riskut?**

Bëhuni kuriozë. Risku nuk është frikë, është të kuptuarit më i mirë i realitetit. Ky profesion kërkon integritet, mendim kritik dhe aftësi për të parë përtej asaj që është e dukshme. Në një botë të pasigurt, ekspertët e riskut do të jenë ndër profesionistët më të kërkuar.

**SIGMA**   
VIENNA INSURANCE GROUP



## Automatizimi i regjistrimit të faturave përmes Inteligjencës Artificiale

Departamenti i Financës në Sigma VIG po hyn në një fazë të re zhvillimi, ku automatizimi dhe inteligjenca artificiale po kthehen në motorë të përmirësimit operacional. Projekti i ri i automatizimit të regjistrimit të faturave të blerjes, është një iniciativë e cila ndërthur platformën SelfCare, teknologjinë e IA-së dhe integrimin automatik me SAP. Kjo ka sjellë një transformim të prekshëm në mënyrën si trajtohen proceset financiare brenda kompanisë.

Nga një proces tradicionalisht manual, i ngarkuar me volum të lartë pune dhe kohë të gjata për përpunim, Sigma VIG ka kaluar në një mekanizëm inteligjent, i cili lexon, përpunon dhe regjistron automatikisht mijëra fatura me saktësi të lartë. Ky projekt përfaqëson jo vetëm një rritje të efikasitetit dhe saktësisë, por edhe një qasje të re strategjike që i lejon ekipit të financës të përqendrohet në analiza me vlerë të shtuar.

I udhëhequr nga fryma transformuese e grupit VIG, ky zhvillim është shembull konkret se si inovacioni dhe teknologjia vendosen në funksion të biznesit, duke shënuar një hap të fortë drejt financës së së ardhmes. Në këtë intervistë, znj. Kozeta Nervaj, Drejtore e Departamentit të Financës, ndan përvojën, vlerësimin dhe vështrimin strategjik mbi ndikimin e këtij projekti inovativ në Sigma VIG.

### **Znj. Kozeta, çfarë ju shtyu të ndërmerrnit këtë projekt transformues në fushën e kontabilitetit?**

Ky projekt lindi si një përgjigje direkte ndaj ritmit të rritur operacional dhe kërkesës për saktësi, efikasitet dhe raportim në kohë reale. Në departamentin e financës, volumi i faturave dhe procesimi manual shpesh krijonin ngarkesë dhe vonesa. Në linjë me filozofinë e grupit, e cila nxit inovacionin dhe automatizimin në proceset, ne pamë një mundësi të qartë për të futur inteligjencën artificiale si një aktor të ri në procese.

### **Si funksionon në praktikë automatizimi i regjistrimit të faturave?**


Procesi është krijuar si një zinxhir inteligjent: faturat e blerjes merren nga platforma SelfCare, IA i lexon, i konverton në format standard dhe gjeneron dokumentin që ngarkohet automatikisht në SAP. Pra, kalojmë nga një proces manual që kërkonte shumë kohë dhe verifikime, në një mekanizëm që punon brenda sekondave, me një nivel saktësie shumë të lartë.

### **Cilat kanë qenë përfitimet më të dukshme për departamentin tuaj?**

Përfitimet kanë qenë të menjëhershme:

- Saktësi e lartë – gabimet njerëzore pothuajse eliminohen.
- Shpejtësi dhe efikasitet – mijëra fatura procesohen automatikisht, duke na çliruar kohë operationale.
- Raportim i përshpejtuar – të dhënat financiare janë gjithmonë të përditësuara dhe gati për analiza.
- Transparencë e zgjeruar – çdo hap gjurmohet në mënyrë elektronike, duke rritur përputhshmërinë ligjore.
- Optimizim i burimeve njerëzore – ekipi fokusohet tek analiza, jo tek detyrat rutinë.

Në thelb, IA nuk e zëvendëson punonjësën e kontabilitetit, përkundrazi, e fuqizon atë, duke i dhënë më shumë hapësirë për detyra strategjike.



## **Si lidhet ky projekt me strategjinë transformuese të Grupit Vienna Insurance Group?**

VIG ka bërë një thirrje të qartë për të gjitha kompanitë e tij, për të vepruar, për të nxitur modernizimin, efikasitetin dhe kulturën e inovacionit në mbarë Grupin. Ky projekt është një shembull konkret i strategjisë së tij nxit: përshtatje e zgjidhjeve të zgjuara, eliminim i burokracive, automatizim i proceseve dhe rritje të vlerës për biznesin.

Ne nuk po automatizojmë vetëm një proces teknik, ne po modernizojmë mënyrën sesi financa funksionon si profesion.

## **Çfarë mesazhi do t'u jepnit kolegëve të tjerë të VIG që po mendojnë të ndërmarrin projekte të ngjashme?**

Mos kini frikë nga teknologjia. Inteligjenca Artificiale nuk është një kërcënim, por një partner strategjik. Futja e saj në procese krijon stabilitet, saktësi dhe efikasitet, duke sjellë realisht vlerë të matshme. Proceset inteligjente janë tashmë standardi i ri, dhe evolucioni nuk pret.

## **Cilat janë planet tuaja për vijimësinë e këtij transformimi?**

Plani ynë është i qartë: zgjerim i mëtejshëm i automatizimit. Ne synojmë të shohim mundësi për integritime të tjera me SAP, përdorim më të thelluar të IA-së për analiza dhe verifikime, si dhe rritje të volumin të proceseve të digitalizuara. Ky është vetëm hapi i parë drejt një finance më të zgjuar dhe më të integruar.

## **Në një fjali - çfarë përfaqëson ky projekt për ju?**

Përfaqëson kalimin nga financa e djeshme tek financa e së ardhmes: më inteligjente, më e shpejtë dhe më e fokusuar në vlerë strategjike.



## **Pas çdo garancie të qëndrueshme, qëndron një strukturë e fortë risigurimi**

Në një industri ku qëndrueshmëria financiare është po aq thelbësore sa edhe besimi i klientit, risigurimi mbetet një nga hallkat më të rëndësishme – edhe pse shpesh e padukshme – të tregut të sigurimeve.

Në këtë intervistë, znj. Elda Berberi, Drejtoreshë e Risigurimeve në SIGMA VIG – Shqipëri, ndan me ne rolin strategjik të risigurimit në ndërtimin e garancive të forta për klientët dhe mënyrën se si një treg i vogël si Shqipëria mund të përfitojë nga partneritetet me gjigantët ndërkombëtarë të kësaj industrie.

Nga sfidat lokale, te përfitimet që sjell për Sigmën të qënurit pjesë e Vienna Insurance Group, kjo bisedë hedh dritë mbi një sektor jetik për stabilitetin dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve.



**Znj. Berberi, ndonëse për publikun e gjerë është një fushë më pak e dukshme, risigurimi është një shtyllë thelbësore në industrinë e sigurimeve. Si do ta përkufizonit rolin e këtij instrumenti?**

Risigurimi është si rrjeta e sigurisë për kompanitë e sigurimit – një mekanizëm që na lejon të marrim përsipër më shumë risk, duke garantuar se kemi mbrojtje të dytë në rast të ngjarjeve të mëdha. Është një element i padukshëm për klientin, por absolutisht kritik për qëndrueshmërinë financiare të çdo kompanie që aspirojnë jetëgjatësi në treg.

**Cilat janë sfidat kryesore në vendosjen dhe menaxhimin e kontratave të risigurimit në tregun shqiptar?**

Sfidat janë të lidhura me natyrën e tregut në të cilin operojmë, ai është një treg i vogël, në zhvillim, me ekspozim relativisht të lartë ndaj rreziqeve natyrore dhe mungesa të theksuara në statistikat historike që të na mundësojë një analizë të saktë. Kjo e bën të domosdoshme ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me risigurues të besueshëm, që nuk ofrojnë vetëm kapacitet financiar, por edhe ekspertizë teknike për vlerësimin e rrezikut. Negociatat e suksesshme varen nga reputacioni, transparenca dhe qasja proaktive që kemi si kompani.

**Sa e rëndësishme është për një kompani sigurimi që të ketë kontrata risigurimi të favorshme dhe partnerë të fortë?**

Është vendimtare. Një strukturë e ndërtuar mbi kushte të favorshme risigurimi e ndihmon kompaninë të operojë me fleksibilitet, të përballojë ngjarje ekstreme pa rrezikuar kapitalin, dhe të mbajë çmime të qëndrueshme për klientët. Partnerët tanë nuk janë thjesht kontraktorë, janë bashkëudhëtarë me ne në menaxhimin e riskut. Kur ke në anën tënde kompani të klasit botëror si VIG Re, Munich Re, Swiss Re, kjo reflektohet në siguri dhe besueshmëri për të gjithë industrinë tonë.

**SIGMA është pjesë e Vienna Insurance Group (VIG). Si ndikon kjo në kontaktet që keni me risigurues ndërkombëtarë dhe në marrëveshjet që arrini?**

Të jesh pjesë e VIG është një avantazh i jashtëzakonshëm. Ne hyjmë në negociata jo si një kompani e vetme nga një treg i vogël, por si pjesë e një grupi me mbi 50 kompani në Europën Qendrore dhe Lindore. Kjo na jep jo vetëm fuqi negociuese më të madhe, por edhe akses të drejtpërdrejtë në panele të konsoliduara risiguruesish me kushte më të mira financiare, struktura teknike më të sofistikuar, dhe mbështetje për zhvillimin e produkteve të reja.



## **Si i përcaktoni objektivat afatgjata të funksionit të risigurimit në SIGMA VIG?**

Objektivi themelor i kompanisë Sigma është të garantojmë vazhdimësinë operacionale dhe të forcojmë qëndrueshmërinë financiare të kompanisë në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të paparashikueshëm. Kjo përfshin ndërtimin e strukturave organizative të diversifikuara dhe elastike, të afta për t'u përshtatur me zhvillimet dinamike të tregut dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë. Një nga prioritetet kryesore është gatishmëria për të përballuar rreziqe të reja dhe në rritje, siç janë ndryshimet klimatike.

Në këtë kuadër, Sigma VIG po investon në transformimin digjital të proceseve kyçe, me fokus në integrimin inteligjent të analizës së të dhënave, për të përmirësuar modelimin e rreziqeve dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë teknike e financiare. Kjo na mundëson të marrim vendime të shpejta dhe të drejta në momentet që kanë më shumë rëndësi për klientët e kompanisë dhe për partnerët tanë.

Në thelb, po ndërtohet një arkitekturë e qëndrueshme e mbrojtjes dhe besimit, ku çdo premtim që SIGMA VIG u bën klientëve nuk është vetëm një kontratë sigurimi, por një angazhim për siguri, besueshmëri dhe partneritet afatgjatë.

# NJË SHTËPI

# E SIGURTË



Vlerësimi i Përgjithshëm dhe Mjedisi i Kontrollit: Auditimet e Brendshme të kryera gjatë vitit 2025 dëshmuar se shoqëria e sigurimit Sigma VIG gëzon një mjedis të fortë kontrolli dhe praktika efektive të menaxhimit të rrezikut në shumicën e fushave operacionale. Një ndër gjetjet pozitive të periudhës ka qenë pajtueshmëria e lartë me kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe me rregulloret e brendshme të funksionimit, gjë që ka rezultuar në një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut në nivelin 'Jeshil' (I ulët). Ky nivel pasqyron kontrolle të implementuara mirë dhe zbutje efektive të rreziqeve. Gjithashtu, është thelbësore të theksohet se gjatë kësaj periudhe nuk u identifikuan gjetje me nivel rreziku 'Të lartë' ose 'Të Mesëm', duke konfirmuar mungesën e çështjeve urgjente apo kritike për t'u adresuar.

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2025 në Fushat Operacionale dhe Financiare Raporti evidentuan efikasitet dhe një performancë shumë të mirë në disa departamente kyçe:

- Financa dhe Administrimi: Proceset e rakordimit të primeve të shkruara midis sistemeve MBA dhe SAP rezultuan materialisht të sakta dhe të barabarta. Menaxhimi i inventarit të policave të sigurimit dhe rakordimi me Byronë Shqiptare të Sigurimit janë kryer në përputhje të plotë me rregulloret.
- Menaxhimi i Debitorëve: Shoqëria e sigurimit Sigma VIG ka treguar efektivitet në ndjekjen e balancave debitore dhe mbledhjen e detyrimeve nga subjektet, duke zbatuar procedura të qarta njoftimi dhe ndjekjeje ligjore në rastet me tejkalim afati.
- Komisionet e Shitjes: Llogaritja dhe regjistrimi i komisioneve dhe bonuseve rezultuan të sakta dhe në përputhje me vendimet e Bordit të Drejtorëve.
- Ri-sigurimi: Ky funksion shfaq një nivel të ulët rreziku, me kontrolle të brendshme të përshtatshme për të gjitha proceset, përfshirë rinovimin e marrëveshjeve dhe llogaritjen e primeve të ceduara. Për këtë fushë nuk u lëshua asnjë rekomandim, duke konfirmuar efikasitetin e plotë.

Trajtimi i Dëmeve dhe Pajtueshmëria Rregullatore: Në fushën e trajtimit të dëmeve, janë shënuar përgjithësisht rezultate pozitive:

- Dëmet TPL Materiale dhe Jo-materiale: Procesi funksionon në mënyrë efektive, me dokumentacion të plotë (proceserbal i policisë, vendime gjyqësore, raporte mjeko-ligjore) dhe vlerësime të bazuara saktësisht në rregulloren e AMF-së.
- Dëmet e Pronës: Kontrollat mbuluan të gjithë zinxhirin e procesit, nga verifikimi i mbulimit deri te miratimi i dëmshpërblimit, duke rezultuar në një profil rreziku 'Jeshil'.

Qeverisja Korporative dhe Burimet Njerëzore: Shoqëria ka treguar angazhim maksimal në qeverisjen korporative, ku funksioni i Menaxhimit të Rrezikut performon sipas kërkesave të AMF-së dhe ato të Grupit VIG. Sa i përket Burimeve Njerëzore, proceset e rekrutimit, llogaritja e pagave dhe sistemi i vlerësimit të performancës janë në pajtueshmëri të plotë me kuadrin ligjor dhe urdhrat e brendshme të menaxhimit.

Si përfundim në tërësi, rezultatet e auditimit të vitit 2025 rikonfirmojnë stabilitetin operacional të shoqërisë Sigma VIG dhe aftësinë e saj për të ruajtur mekanizma kontrolli të cilat jo vetëm parandalojnë rreziqet, por edhe zbusin pasojat e mundshme në mënyrë efektive.





Risigurimi përbën një nga elementët themelorë të veprimtarisë së sigurimit, pasi luan një rol kyç në forcimin e aftësisë paguese të shoqërisë dhe në garantimin e stabilitetit financiar në rastet e dëmeve me përmasa të mëdha. Nëpërmjet një programi risigurimi të strukturuar dhe të menaxhuar me kujdes, SIGMA VIG vijoi edhe gjatë vitit 2025 të përmbushë në kohë rekord detyrimet ndaj klientëve të dëmtuar, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin financiar dhe vazhdimësinë e aktivitetit të saj.

Përzgjedhja e partnerëve risigurues mbetet një faktor me rëndësi strategjike, jo vetëm për garancinë financiare që u ofrohet të siguruarve, por edhe për ekspertizën teknike dhe mbështetjen profesionale që ata ofrojnë gjatë vlerësimit dhe administrimit të dëmeve. Ky bashkëpunim merr një rëndësi të veçantë në rastet e ngjarjeve katastrofike, kur fluksi i kërkesave për dëm rritet ndjeshëm brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe kërkon kapacitete të larta teknike e operacionale.

Në këtë kuadër, SIGMA VIG, me mbështetjen e Vienna Insurance Group, ka vijuar të investojë në ndërtimin e partneriteteve me risigurues të mirënjohur ndërkombëtarë për transferimin e riskut. Këta partnerë sigurojnë mbulim të plotë për dëmet individuale dhe katastrofike, ndërkohë që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve profesionale të shoqërisë përmes asistencës teknike, shkëmbimit të njohurive dhe programeve të trajnimit të stafit për menaxhimin e situatave komplekse.

## Vetëvlerësimi i Risqeve dhe Aftësisë Paguese

1. Procesi i vetëvlerësimit të Risqeve dhe aftësisë paguese të shoqërisë përbëhet nga disa faza:

- a. Procesi i Kontrollit të Risqeve
  - b. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
  - c. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ
  - d. Monitorimi, masat dhe kontrollet
  - e. Raportimi
2. Prova e Rezistencës
  3. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese
  4. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij
  5. Profili i Përgjithshëm i Riskut



## Procesi i Kontrollit të Risqeve

Procesi i menaxhimit dhe kontrollit të risqeve fillon me identifikimin dhe inventarizimin sistematik të tyre. Duke u mbështetur në metodologjitë, modelet dhe praktikat më të mira të Vienna Insurance Group (VIG), SIGMA VIG ka identifikuar dhe klasifikuar risqet kryesore që lidhen me veprimtarinë e saj. Për secilin risk të identifikuar kryhet vlerësimi i probabilitetit të ndodhjes dhe i ndikimit të mundshëm, përcaktohet metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të tij, si dhe dokumentohen masat kontrolluese dhe veprimet parandaluese të nevojshme për menaxhimin efektiv të ekspozimit ndaj riskut.

## Prova e Rezistencës

Provat e rezistencës (Stress Tests) përbëjnë një instrument të rëndësishëm në kuadrin e menaxhimit të riskut dhe përdoren për të vlerësuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë ndaj ngjarjeve me probabilitet të ulët ndodhjeje, por me ndikim potencialisht të lartë. Metodatat kryesore të përdorura janë analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e skenarëve, të cilat mundësojnë vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve në faktorët kryesorë të riskut mbi pozicionin financiar të shoqërisë.

Në këtë proces, faktorët makroekonomikë luajnë një rol të rëndësishëm, pasi risqet e tregut, të kreditit dhe ato operacionale ndikohen drejtpërdrejt nga luhatjet e normave të interesit, ndryshimet në vlerën e asetëve financiare dhe lëvizjet e kursit të këmbimit. Rezultatet e këtyre analizave shërbejnë si bazë për forcimin e proceseve të menaxhimit të riskut dhe për ruajtjen e stabilitetit financiar të shoqërisë.

### Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Bazuar ne ligjin nr. 52/2014 date 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", shoqëria duhet të mbajë një fond garancie minimum në shumën 370 milion lekë (ose jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë paguese minimale).

### Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij

Plani i vazhdimësisë së aktivitetit është formuluar dhe është perditesuar nga shoqëria për tju pershtatur ndryshimeve në strukturën e shoqërisë. Në plan parashikohen hapat që duhet të ndërmerren në rast të llojeve të ndryshme të katastrofave, si dhe përcaktohen personat përgjegjës për grupet e ndryshme të punës.

### Profili i Përgjithshëm i Riskut dhe Konkluzioni

Duke konsideruar të gjithë analizën e mesiperme dhe gjetjet e rezultuara, arrijme në përfundim që shoqëria ka një nivel menaxhueshëm të riskut në teresi.

### Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Qëllimi i procesit të inventarizimit është identifikimi dhe kategorizimi i Risqeve. Risqet kryesore të identifikuara ndërkombëtare janë:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes në Sigurim se Jo-jetes
- Risku i Marrjes në Sigurim se Produktit të Shendetit
- Risku i Aktiveve të Patrupezuara
- Risku i Falimentimit të Pales Tjeter
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
- Risku i ndërprerjeve të aktivitetit
- Risku i përqendrimit të njohurive
- Risku i burimeve njëzore të pamjaftueshme
- Risku i hardëare dhe infrastruktures
- Risku i softëare dhe i sigurisë
- Risku i modelimit dhe kualitetit të të dhënave
- Risku i zhvillimit të IT
- Risku i projekteve
- Risku i përputhshmërisë ligjore të lidhura me sigurimet
- Risku i përputhshmërisë ligjore të tjera
- Risku i proceseve dhe organizimit
- Risku i gabimeve njëzore
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

### Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ

Në këtë proces bëhet vlerësimi i risqeve materiale. Vlerësimi bëhet në bazë të dy parimeve : frekuenca dhe shkalla e rëndësisë.


### Monitorimi, masat dhe kontrollet

Monitorimi i të gjithë risqeve është i detyrueshëm dhe kryhet të paktën një herë në vit. Në këtë proces monitorimi merr rëndësi vlerësimi i bërë i riskut dhe ndarja sipas shkallës së rrezikut.

### Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqërisë përmban nivelet e risqeve dhe masat që duhen marrë për ato risqe të klasifikuara shqetësuese. Gjithashtu puna audituese është përqëndruar në zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të brendshme të Bordit Drejtues lidhur me menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes.

# ORGANIGRAMA



## Sigma VIG nderohet sërish me çmimin Günter Geyer, duke e shndërruar kujdesin për të tjerët në një ndikim të matshëm

Tiranë, Shqipëri – 16.04.2026

Ka momente kur ndikimi në shoqëri shkon përtej treguesve financiarë dhe shndërrohet në diçka më njerëzore, më të ndjerë, përmes lidhjes dhe përgjegjësisë së përbashkët. Pikërisht në këtë dimension, Vienna Insurance Group (VIG) ka nderuar sërish Sigma VIG me çmimin prestigjioz Günter Geyer për kontribut social.

Ky çmim ka marrë emrin e Presidentit të Bordit Mbikëqyrës të Wiener Städtische Versicherungsverein, dhe akordohet nga aksioneri kryesor i VIG për kompanitë e Grupit të cilat kanë dëshmuar angazhim të jashtëzakonshëm në fushën sociale. Është hera e dytë që Sigma VIG e fiton këtë çmim, duke reflektuar kështu që këto nuk janë aktivitete të izoluara, por një përkushtim i vazhdueshëm për të përcaktuar rolin dhe ndikimin e sigurimit në jetën e njerëzve.



Çmimi u dorëzua zyrtarisht nga anëtarë të Bordit të VIG për Bordin e Sigma VIG, në një ceremoni që bashkoi përfaqësues të medias, partnerë dhe anëtarë të komunitetit i cili qëndron në thelb të kësaj historie.

### Kur kërkimi shkencor bashkohet me humanizmin

Ky rrugëtim nuk nisi në një sallë mbledhjesh, por nga një pyetje e thjeshtë: si mund të përmirësojmë cilësinë e jetës për të moshuarit, të cilët shpesh mbeten në periferi të vëmendjes së shoqërisë? Sigma VIG mbështeti iniciativën e Prof. Dr. Robert Çitozi dhe z. Klajdi Xhebexhiu nga Universiteti I Sporteve, Tiranë për zbatimin e programit të ushtrimeve ndërkombëtarisht të njohura, Otago, në një institucion publik të kujdesit për të moshuarit.

Ajo që pasoi ishte një transformim 12-javor, i strukturuar me rigorozitet profesional dhe ndjeshmëri njerëzore. Njëzet e katër rezidentë u bënë pjesë e një ritmi të mirëprojektuar aktiviteteve, ku lëvizja dhe ndërveprimi u kthyen në elemente kyçe të përditshmërisë. Përgjatë 36 seancave, dita u riorganizua përmes ushtrimeve të lehta, shëtitjeve në natyrë dhe momenteve të muzikës dhe vallëzimit.

Në pamje të parë mund të dukej e thjeshtë, por në thelb bëhej fjalë për një ndërhyrje të strukturuar që adresonte një nga rreziqet më kritike në shëndetin e të moshuarve: humbjen e ekuilibrit dhe dëmtimet që rrjedhin prej saj, të cilat shpesh përcaktojnë cilësinë e jetës në moshë të thyer.

Në përfundim të programit, rezultatet ishin të qarta dhe të matshme. Ekuilibri fizik u përmirësua ndjeshëm, forca dhe qëndrueshmëria u rritën, duke sjellë me vete një ndjenjë të re besimi dhe autonomie. Megjithatë, ndikimi real tejkaloi dimensionin fiziologjik.

U shtua e geshura. U rrit komunikimi. U vu re një ndryshim i dukshëm në gjendjen emocionale, u rrit optimizmi dhe mënyra se si pjesëmarrësit u angazhuan jo vetëm me programin, por edhe me njëri-tjetrin. Lëvizja u shndërrua në një gjuhë e cila i lidhte me veten dhe me botën përreth.

### **Për një të ardhme të sigurt: Fuqizimi i brezit të ri përmes edukimit për sigurinë rrugore**

Në partneritet Kryqin e Kuq Shqiptar, ekipet tona u angazhuan në mënyrë aktive në një fushatë ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore, duke përforcuar angazhimin tonë strategjik për ndikim në shoqëri dhe parandalimin e rrezikut. E fokusuar tek fëmijët e moshës 7–13 vjeç, iniciativa u implementua në disa shkolla, duke kombinuar edukimin me ndërveprimin praktik për të promovuar një sjellje të përgjegjshme që në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve.



Përmes një qasjeje dinamike që ndërthurte të mësuarit me elementë loje, nxënësit u njohën me parimet bazë të sigurisë rrugore, të mbështetura nga materiale informuese dhe demonstrime praktike të realizuara nga vullnetarë të Kryqit të Kuq dhe specialistë të sigurisë rrugore.

Programi përfshiu gjithashtu trajnime praktike të ndihmës së parë në skenarë aksidentesh, duke pajisur pjesëmarrësit e vegjël me njohuri bazë të cilat nevojiten në raste të tilla. Angazhimi i lartë dhe entuziazmi i treguar si nga nxënësit ashtu edhe nga punonjësit tanë konfirmuan vlerën e prekshme të bashkëpunimit në ndërtimin e komuniteteve më të sigurta për të ardhmen.

### **Përtej mbështetjes financiare: Prania e stafit si vlera më e madhe**

Roli i Sigma VIg nuk u kufizua në mbështetjen e projektit, por u integrua thellësisht në vetë zbatimin e tij. Në mënyrë domethënëse, punonjësit e Sigma VIg u bënë pjesë aktive e këtij rrugëtimi. Ajo që u krijua ishte një urë lidhëse ndërmjet brezave, ndërmjet qëllimit dhe veprimit, ndërmjet kujdesit dhe pranisë reale.

### **Nga perspektiva e Grupit, ky çmim konsolidon një vizion më të gjerë strategjik.**

*"Me çmimin 'Günter Geyer Award for Social Conscience', i themeluar në vitin 2012, ne vendosim në mënyrë të qëllimshme në qendër të vëmendjes angazhimin social të kompanive të grupit tonë. Ky çmim vlerëson ata, të cilët përmes iniciativave të tyre, japin një kontribut të rëndësishëm për një shoqëri moderne dhe të dobishme. Përgëzoj ngrohtësisht Sigma për këtë arritje dhe falënderoj të gjithë ata që janë përfshirë në këto aktivitete për angazhimin e tyre dhe lidhjen e brezave në shoqërinë civile në Shqipëri",* u shpreh **Robert Lasshofer**, Kryetar i Bordit të Menaxhimit të Wiener Städtische Versicherungsverein, aksioneri kryesor i Vienna Insurance Group (VIg).

## Një vlerësim që reflekton vazhdimësi

Marrja e çmimit Günter Geyer për herë të dytë e pozicionon Sigma VIG në një nivel të veçantë brenda Vienna Insurance Group (VIG): si një kompani që nuk e trajton përgjegjësinë sociale si një iniciativë të izoluar, por si një disiplinë të integruar në modelin e saj operacional.

*“Ky vlerësim nuk është një pikë mbërritjeje, por një përgjegjësi,”* u shpreh **Klaidi Çitozi**, CEO i Sigma VIG. *“Ai na motivon të vazhdojmë të krijojmë ndikim që nuk është thjesht i matshëm, por realisht domethënës. Këto iniciativa reflektojnë bindjen tonë se parandalimi, edukimi dhe angazhimi komunitar janë shtylla thelbësore për krijimin e vlerës së qëndrueshme. Në thelb, sigurimi ka të bëjë me njerëzit: mbrojtjen e jetës, ndërtimin e mjediseve më të sigurta dhe kontributin në mirëqenien afatgjatë të komuniteteve të cilave ju shërbejmë.”*

Duke përforcuar më tej perspektivën e Grupit, **Christoph Rath**, anëtar i Bordit Drejtues të Vienna Insurance Group, shtoi: *“Dëshiroj të përgëzoj ngrohtësisht ekipin e Sigma për këtë çmim të merituar. Përmes iniciativave si projekti Otago, i cili synon përmirësimin e ekuilibrit dhe reduktimin e rrezikut të rrëzimeve tek të moshuarit, si dhe programeve të sigurisë rrugore të zhvilluara në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, Sigma demonstron ndikimin konkret të angazhimit të saj lokal — të nxitur nga përkushtimi personal i punonjësve të saj. Ky është një shembull i shkëlqyer i mënyrës se si ne, si Vienna Insurance Group, marrim përgjegjësi përtej aktivitetit tonë kryesor në vendet në të cilat operojmë.”*

Duke parë përpara, ambicia e Sigma VIG është e qartë: të zgjerojë iniciativa që integrojnë kërkimin shkencor, angazhimin komunitar dhe dimensionin njerëzor në modele të shkallëzueshme ndikimi.





## Përgjegjësia Sociale 2025

### Përgjegjësi dhe angazhim shoqëror

Me një eksperiencë mbi 26-vjeçare në tregun shqiptar të sigurimeve, Sigma Vienna Insurance Group – kompania e parë private e sigurimeve në vend dhe pjesë e Vienna Insurance Group që nga viti 2007 – vijon të kombinojë profesionalizmin e përditshëm me angazhimin për kauza me ndikim shoqëror. Në përputhje me filozofinë e përgjegjësisë sociale korporative (CSR), Sigma VIG synon të identifikojë dhe të mbështesë iniciativa që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit, duke rritur ndërgjegjësimin dhe veprimin shoqëror në fusha me rëndësi si arsimit, sporti, bamirësia, siguria dhe informimi publik.

Gjatë vitit 2025, kompania ka vijuar të forcojë rolin e saj si partner i besueshëm në projekte me ndikim pozitiv, duke bashkëpunuar me institucione, organizata dhe aktorë të ndryshëm për të sjellë ndryshim konkret në komunitet. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe motivimit dhe përfshirjes së punonjësve, si pjesë e kulturës së kompanisë që inkurajon aktivizimin social dhe kontributin personal në kauza me vlerë të lartë shoqërore. Më poshtë paraqiten disa nga projektet me përgjegjësi sociale që Sigma Vienna Insurance Group ka realizuar gjatë vitit 2025.



### Tirana Junior Basket

Brezi i ri, veçanërisht fëmijët e lindur pas vitit 2010, po rriten në një botë gjithnjë e më të ndikuar nga teknologjia dhe rrjetet sociale, çka shpesh i largon nga aktivitetet fizike dhe jeta aktive. Me këtë sfidë në mendje, Sigma Vienna Insurance Group vijon të mbështesë iniciativa që nxisin sportin, shëndetin dhe bashkëpunimin tek fëmijët. Në këtë kuadër, kompania jonë iu bashkua me entuziazëm nismës “Tirana Junior Basket”, të organizuar nga Çaçi Basket, me misionin për të promovuar një mënyrë jetese aktive dhe për të krijuar traditë në zhvillimin e sportit të basketbollit për fëmijët. Edicioni i tretë i Tirana Junior Basket, zhvilluar gjatë muajit qershor 2025, mbledhi mbi 300 fëmijë të moshës 6–14 vjeç në një mini-kampionat plot energji dhe argëtim. Ndarë në skuadra sipas grupmoshave, pjesëmarrësit dhanë maksimumin në çdo sfidë, duke përjetuar emocionet e lojës, frymën e ekipit dhe gëzimin pas çdo fitoreje. Për Sigma VIG, mbështetja e iniciativave të tilla është një mënyrë konkrete për të kontribuar në formimin e brezave të rinj, për të forcuar vetëbesimin, disiplinën dhe bashkëpunimin, duke i përgatitur fëmijët jo vetëm për sportin, por edhe për sfidat e jetës.



## Kriza klimatike dhe ndërgjegjësimi i brezave të rinj

Në kuadër të angazhimit të SIGMA Vienna Insurance Group për qëndrueshmëri mjedisore dhe përgjegjësi shoqërore, pjesë e objektivave të saj ESG (Environmental, Social, Governance), kompania ka vijuar edhe gjatë vitit 2025 me aktivitete që synojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezave të rinj mbi çështjet mjedisore. Më 22 prill 2025, në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, stafi i SIGMA VIG zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësuës me nxënësit e Gjymnazit "Sami Frashëri" në Tiranë, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Tiranë. Takimi u fokusua në ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, përmes prezantimeve, materialeve edukative dhe broshurave informuese që synonin të frymëzonin të rinjtë për veprim konkret. Nxënësit morën pjesë aktive me prezantime dhe krijime artistike mbi temën e mjedisit, duke sjellë ide të reja dhe një frymë optimizmi për të ardhmen e planetit. Aktiviteti u vlerësua nga Drejtoresha e Komunikimit dhe Marketingut të SIGMA VIG, znj. Dorinela Ndrejaj, e cila theksoi: "Ky aktivitet është pjesë e përkushtimit tonë afatgjatë për të ndërtuar ura bashkëpunimi me komunitetin dhe për të edukuar brezat e rinj mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Për ne, ESG nuk është vetëm një standard ndërkombëtar, por një përgjegjësi e përditshme ndaj shoqërisë dhe brezave që vijnë."

Edhe Drejtoresha e shkollës "Sami Frashëri", znj. Majlinda Ziu, falënderoi SIGMA VIG dhe Kryqin e Kuq për kontributin, duke theksuar se ndërgjegjësimi për mbrojtjen e planetit duhet të jetë një përpjekje e përditshme, jo vetëm në Ditën e Tokës. Në të njëjtën frymë, më 13 tetor 2025, në Ditën Ndërkombëtare të Reduktimit të Fatkeqësive Natyrore, SIGMA VIG dhe Kryqi i Kuq – Dega Tiranë zhvilluan një tjetër aktivitet edukativ me nxënësit e shkollës "A.Z. Çajupi" në Tiranë.



## **Festa e 1 Qershorit pranë Shtëpisë së Foshnjes, Tiranë “Hannah dhe Rozafa”**

Në prag të Festës së Fëmijëve, stafi i kompanisë SIGMA VIG u bashkua në një nismë të veçantë për të festuar 1 Qershorin, me ata që kanë më shumë nevojë për kujdes dhe dashuri – fëmijët e shtëpisë së foshnjës “Hannah dhe Rozafa”. Kjo ide frymëzuese, e iniciuar nga disa kolegë, u përqaftua me entuziazëm nga i gjithë ekipi. Me kontributet e tyre vullnetare, u bë i mundur organizimi i një feste të ngrohtë dhe plot ngjyra, me aktivitete të dedikuara, animatorë profesionistë dhe dhurata të shumta për fëmijët. Lodra edukative, veshje të reja, produkte higjienike, dhe një pishinë portative për ditët e nxehta të verës — të gjitha u menduan me kujdes për të sjellë gëzim dhe lehtësim në jetën e përditshme të fëmijëve. Atmosfera u bë edhe më e veçantë falë pranisë së fëmijëve të disa prej punonjësve të SIGMA VIG, të cilët u bënë pjesë aktive e festës. Ata luajtën, qeshën dhe ndanë momente të singërta me fëmijët e shtëpisë, duke krijuar ura të bukura empatie dhe miqësie. Ishte një ditë që nuk bëri vetëm dhurata – por shkëmbeu shumë dashuri. Për SIGMA, pjesë e Vienna Insurance Group, përgjegjësia sociale nuk është thjesht një politikë e kompanisë – është kthyer në një mënyrë jetese. Duke fuqizuar nisma që lindin nga zemra e stafit dhe duke krijuar hapësira ku komuniteti dhe familja ndërthuren, ne ndërtojmë një kulturë të solidaritetit të vërtetë dhe ndikimi të qëndrueshëm në shoqëri. Ky aktivitet është një dëshmi se si një veprim i përbashkët, i nisur me dashuri dhe vullnet të mirë, mund të ndriçojë ditën dhe të lërë gjurmë në zemrat e të gjithëve – të vegjël dhe të rritur.



## Book Club- Book Truck

Me synimin për të qenë një aktor ndikues në ndërgjegjësimin dhe edukimin e brezit të ri, i cili sot është gjithnjë e më shumë i përfshirë nga teknologjia, Sigma Vienna Insurance Group ka zgjedhur të rikthejë vëmendjen tek libri – burimi tradicional i dijes dhe krijimtarisë. Në këtë frymë, gjatë muajit qershor 2025, stafi i SIGMA VIG u bë pjesë e projektit të veçantë “Book Club – Book Truck”, një nismë e dedikuar për të nxitur dashurinë për leximin dhe për të krijuar klube leximi në disa njësi administrative të Tiranës dhe më gjerë. Qëllimi i projektit ishte të inkurajojë leximin, kreativitetin dhe komunikimin tek fëmijët e moshës 8–12 vjeç, duke i përfshirë ata në aktivitete të hapura dhe interaktive. Në kuadër të kësaj nisme, SIGMA VIG kontribuoi përmes dhurimit të paketave me libra, aksesore dhe lojëra edukative, të përgatitura posaçërisht për fëmijët pjesëmarrës. Stafi i kompanisë u bashkua në ditët e aktivitetit pranë fëmijëve në Pezë, Shëngjergj dhe Shkodër, duke shpërndarë librat, zhvilluar lojëra dhe lexuar bashkë me ta – një përvojë frymëzuese që riktheu emocionin e leximit si një udhëtim magjik. Falë suksesit të edicionit të parë, projekti vijoi edhe gjatë muajve tetor–nëntor 2025, ku ekipi i SIGMA VIG u rikthye në terren për të ndihmuar fëmijët të zbulojnë botën e librit përmes leximit të përbashkët dhe interpretimit të mesazheve që ai përcjell. Kjo nismë përfaqëson angazhimin e vazhdueshëm të SIGMA Vienna Insurance Group për të investuar në arsim, kulturë dhe zhvillim të brezave të rinj, duke ndërtuar një komunitet lexuesish të frymëzuar dhe të vetëdijshëm për vlerën e dijes.



## Të njohim risqet – Edukim dhe ndërgjegjësim për brezin e ri

Në muajin tetor 2025, Sigma VIG mirëpriti në zyrat qendrore nxënësit e klasës së 8-të të shkollës Shkolla “Dëshmorët e Lirisë”, në kuadër të një aktiviteti edukativ me fokus zhvillimin e një ore mësimore interaktive mbi konceptin e riskut. Ky aktivitet synoi rritjen e ndërgjegjësit të të rinjve mbi rreziqet që i rrethojnë në jetën e përditshme, mënyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes ndaj tyre, si edhe orientimin e hershëm drejt identifikimit të prirjeve dhe pasioneve personale në funksion të zgjedhjeve të ardhshme profesionale. Gjatë takimit me ekipin e Sigma VIG, nxënësit u njohën më nga afër me industrinë e sigurimeve, rolin e saj në shoqëri dhe mundësitë për ndërtimin e një karriere të qëndrueshme në këtë sektor. Aktiviteti konfirmoi rëndësinë e investimit në edukimin financiar dhe profesional të brezit të ri, duke nxitur frymëzim, përgjegjshmëri dhe orientim të qartë drejt së ardhmes.



## Dhurata për fëmijët e shtruar në pediatri gjatë festave të fundvitit

Në frymën e përgjegjësisë sociale dhe të solidaritetit komunitar, Sigma iu bashkua me përkushtim nismës së ndërmarrë nga studentët e mjekësisë në Tiranë, me qëllim sjelljen e buzëqeshjes dhe momenteve të gëzimit për fëmijët që i kalojnë festat e fundvitit të shtruar në pediatri. Stafi i Sigma përgatiti paketa të dedikuara me dhurata, duke përzgjedhur si element qendror librin artistik – një mjet frymëzimi dhe zhvillimi për fëmijët. Krahas librave, paketat përfshinë edhe mjete shkollore si blloqe, stilolapsa dhe ngjyra, të cilat synojnë të nxisin kreativitetin dhe të ofrojnë një hapësirë pozitive argëtimi gjatë periudhës së trajtimit në pediatri të Tiranës. Përmes fuqisë së leximit dhe imagjinatës, këto dhurata kontribuojnë në krijimin e një përvojë më të ngrohtë dhe shpresëdhënëse për fëmijët, duke i ndihmuar ata të kapërcejnë përkohësisht sfidat e sëmundjes. E angazhuar për të qenë pranë çështjeve sociale me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, Sigma mbetet e motivuar të mbështesë iniciativa që sjellin vlerë reale dhe prekje njerëzore, veçanërisht për më të vegjlit në momente delikate si festat e fundvitit.



Duke u mbështetur në rezultatet e arritura gjatë vitit 2025 dhe në strategjinë afatgjatë të zhvillimit, SIGMA Vienna Insurance Group do të vijojë edhe gjatë vitit 2026 të fokusohet në forcimin e pozicionit të saj në tregun shqiptar të sigurimeve, përmes rritjes së qëndrueshme, inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të përvojës së klientit.

Prioritetet kryesore për vitin 2026 janë:

- Rritja e portofolit të sigurimeve në segmentet strategjike, duke ruajtur një zhvillim të balancuar dhe një strukturë të shëndoshë të riskut.
- Zgjerimi i kanaleve digjitale të shitjes dhe shërbimit, me fokus në automatizimin e proceseve, rritjen e aksesueshmërisë së produkteve dhe përmirësimin e eksperiencës së klientit.
- Vijimi i investimeve në transformimin digjital, modernizimin e proceseve të brendshme dhe zhvillimin e zgjidhjeve inovative që rrisin efikasitetin operacional dhe cilësinë e shërbimeve.
- Ruajtja e një pozicioni të fortë financiar dhe kapitalizimi i shoqërisë, në përputhje me kërkesat rregullatore dhe standardet e Vienna Insurance Group, duke garantuar një nivel të lartë të aftësisë paguese dhe të mbulimit të detyrimeve teknike.
- Forcimi i sistemit të menaxhimit të riskut, kontrollit të brendshëm dhe qeverisjes korporative, në funksion të rritjes së qëndrueshme dhe mbrojtjes së interesave të klientëve dhe aksionarëve.
- Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve dhe shërbimeve të sigurimit, në përputhje me nevojat në ndryshim të individëve dhe bizneseve, duke ofruar zgjidhje fleksibël dhe konkurruese.
- Rritja e investimeve në zhvillimin profesional të punonjësve, promovimin e kulturës së inovacionit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve organizative.
- Vijimi i angazhimit ndaj parimeve të përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me vlerat dhe standardet e Vienna Insurance Group.

Përmes realizimit të këtyre objektivave, SIGMA VIG synon të konsolidojë më tej pozicionin e saj si një nga shoqëritë lider të sigurimeve në Shqipëri, duke krijuar vlerë të qëndrueshme për klientët, partnerët, aksionarët dhe komunitetin.





# Raporti i Audituesit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare 2025

## Raporti i Audituesit të Pavarur

**Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Sigma Vienna Insurance Group Sh.a.**

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Sigma Vienna Insurance Group Sh.a' (më tej referuar si "Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduar bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2025 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). në përputhje me ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe siç përcaktohet në shënimin 2.Baza e përgatitjes.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Informacione të tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor të Sigma Vienna Insurance Group sh.a., të përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe raportit të auditorit tonë mbi to. Menaxhimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Raporti vjetor i Shoqërisë për vitin 2025 pritet të vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Mendimi ynë për pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë përfundimi sigurie mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër kur të bëhet i disponueshëm dhe, duke vepruar kështu, të marrim parasysh nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare të konsoliduara ose me njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose ndryshe duket të jetë i gabuar materialisht.

## Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet gjatë auditimit të pasqyrave financiare për periudhën aktuale. Këto çështje, si dhe rreziqet përkatëse të anomalive materiale, janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe në formimin e opinionit tonë mbi to, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë mbi këto çështje.

## KAM 1: Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit – rezervat e dëmeve

Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditim
<p>Detyrimet e kontratës së sigurimit përfaqësojnë detyrimin më të madh në bilancin e kompanisë. Vlerësimi i tyre përfshin gjykim të rëndësishëm dhe përdorimin e modeleve aktuariale që përfshijnë supozime në lidhje me shpeshësinë dhe ashpërsinë e kërkesave në të ardhmen, modelet e zhvillimit të humbjeve, inflacionin, tendencat gjyqësore dhe variabla të tjerë. Ndryshimet e vogla në këto supozime mund të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare.</p> <p>Për shkak të kompleksitetit të modeleve të përdorura, subjektivitetit të supozimeve dhe materialitetit të bilanceve të përfshira, vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit është identifikuar si një çështje kyçe e auditimit.</p>	<p>Procedurat tona të auditimit përfshinin, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Angazhimi i specialistit tonë të pavarur aktuarial në përputhje me ISA 620 për të vlerësuar metodologjitë dhe modelet e përdorura nga menaxhmenti për vlerësimin e detyrimeve të kontratave të sigurimit.</li><li>- Testimi i plotësisë dhe saktësisë së të dhënave themelore të përdorura në llogaritjet aktuariale.</li><li>- Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve kryesore duke i krahasuar ato me përvojën historike, standardet e industrisë dhe inputet e vëzhgueshme të tregut.</li><li>- Vlerësimi i procesit të menaxhimit për vendosjen e supozimeve dhe rishikimin e kornizës së qeverisjes mbi ndryshimet e modelit aktuarial.</li><li>- Kryerja e rillogaritjeve të pavarura, në bazë të mostrës, të vlerësimeve të caktuara të rezervave.</li><li>- Vlerësimi i përshtatshmërisë së zbulimeve në lidhje me detyrimet e kontratave të sigurimit në pasqyrat financiare.</li></ul>
<p><b>Konkluzioni i auditorit:</b> Bazuar në procedurat tona dhe punën e aktuarit të pavarur, konsiderojmë se vlerësimi i rezervave teknike të sigurimit është i arsyeshëm dhe në përputhje me ligjin nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe politikat e kontabilitetit të detajuara në shënimin 2. Ne nuk identifikuam ndonjë deklaratë të gabuar materiale</p>	

## KAM 2: Vlerësimi i rezervës së primeve të pafituara dhe rezervës së rrezikut të paskaduar

Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditim
<p>Rezerva e Primit të Pafituar (UPR), duke përfshirë Rezervën e Rrezikut të Paskaduar (URR), është detyrimi i dytë më i madh në bilanc dhe përcakton drejtpërdrejt shumën e të ardhurave nga primet e sigurimit të njohura në periudhë.</p> <p>Reziqet kryesore lidhen me plotësinë dhe saktësinë e të dhënave themelore të politikave, aplikimin e saktë të metodologjisë proporcionale në të gjitha linjat e biznesit dhe gjykimin e përfshirë në Testin e Përshtatshmërisë së Përgjegjësisë (LAT) dhe përcaktimin e URR.</p> <p>Ne e identifikuar këtë si një çështje kryesore të auditimit për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë midis llogaritjes së UPR dhe të ardhurave të raportuara nga primet.</p>	<p>Procedurat tona të auditimit përfshinin, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Angazhimi i specialistit tonë të pavarur aktuarial për të audituar të gjitha llogaritjet UPR dhe URR, verifikimin e metodologjisë Pro Rata Temporis dhe llogaritjet e UPR të risigurimit sipas llojit të kontratës.</li><li>- Testimi i plotësisë dhe saktësisë së të dhënave themelore të politikave, rakordimi i bilanceve të primeve dhe rezervave me librin e përgjithshëm dhe kthimet rregullatore.</li><li>- Kryerja e rillogaritjeve të pavarura të UPR në një mostër të politikave në të gjitha linjat materiale të biznesit.</li><li>- Rishikimi i Testit të Përshtatshmërisë së Përgjegjësisë dhe llogaritjeve të URR, duke konfirmuar mjaftueshmërinë e përgjithshme të rezervës në të gjitha linjat.</li><li>- Kryerja e procedurave krahasuese analitike dhe të serive kohore.</li></ul>
<p><b>Përfundimi i auditorit:</b> Bazuar në procedurat tona dhe punën e aktuarit të pavarur, UPR dhe URR janë llogaritur me saktësi në përputhje me Ligjin Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe politikat e kontabilitetit të detajuara në Shënimin 2. Ne nuk identifikuar ndonjë deklaratë të gabuar materiale.</p>	

### KAM 3: Rikuperueshmëria e aktiveve të risigurimit

Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditim
<p>Aktivët e risigurimit përfaqësojnë një bilanc të rëndësishëm në bilancin e Kompanisë, duke përfshirë pjesën e risiguresve të rezervave të dëmeve dhe të primit të pafitur. Kompania gjithashtu mbart një detyrim depozite risigurimi me risiguresin e saj kryesor.</p> <p>Rreziqet kryesore janë cilësia e kredisë së palëve të risigurimit, saktësia e llogaritjeve të cesionit dhe kontabiliteti i saktë për marrëveshjen e depozitave të risigurimit.</p> <p>Ne e identifikuar këtë si një çështje kyçe të auditimit për shkak të madhësisë së bilancit dhe kompleksitetit të strukturave të risigurimit.</p>	<p>Procedurat tona të auditimit përfshinin, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vlerësimi i aftësisë kreditore të palëve kryesore të risigurimit duke shqyrtuar vlerësimet e disponueshme të kredisë dhe duke konfirmuar se nuk ekzistonte prova objektive të dëmtimit sipas SNK 39.</li><li>- Testimi i aplikimit të normave të cesionit kontraktual në bazë kampionore, duke konfirmuar konsistencën me vlerësimet e rezervës bruto të audituara sipas KAM 1.</li><li>- Rishikimi i kushteve dhe trajtimit kontabël të depozitës së risigurimit, duke përfshirë tarifën e interesit dhe mekanizmin e kompensimit të dëmeve.</li><li>- Kryerja e testimit të ndërprerjes së primeve të dhëna dhe rakordimi i të ardhurave të komisionit të risigurimit me deklaratat e traktatit dhe konfirmimet e palës.</li></ul>
<p><b>Përfundimi i auditorit:</b> Bazuar në procedurat e kryera, aktivët e risigurimit maten në mënyrë të përshtatshme pa tregues të dëmtimit sipas SNK 39. Depozita e VIG AG llogaritet saktë. Ne nuk identifikuar një deklaratë të gabuar materiale.</p>	

#### KAM 4: Investment Securities and Term Deposits

Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditim
<p>Letrat me vlerë të investimeve dhe depozitat me afat në banka së bashku përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të totalit të aktiveve dhe kërkohen nga AMF-ja për të mbuluar rezervat teknike të sigurimit.</p> <p>Rreziqet kryesore janë përshtatshmëria e klasifikimit sipas SNK 39, saktësia e matjes së kostos së amortizuar, vlerësimi i treguesve të dëmtimit dhe pajtueshmëria me kërkesat e mbulimit të aktiveve të AFSA.</p> <p>Ne e identifikuam këtë si një çështje kryesore të auditimit për shkak të madhësisë së këtyre bilanceve dhe rëndësisë së tyre si aktive që gjenerojnë të ardhura dhe si bazë rregullatore e kapitalit.</p>	<p>Procedurat tona të auditimit përfshinin, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vlerësimi i përshtatshmërisë së klasifikimit të kredive dhe të arkëtueshmeve, duke konfirmuar mungesën e një tregu sekondar aktiv dhe qëllimin dhe aftësinë e menaxhmentit për të mbajtur deri në maturim.</li><li>- Kryerja e rillogaritjeve të pavarura të kostos së amortizuar për një mostër letrash me vlerë duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.</li><li>- Vlerësimi i treguesve të dëmtimit si për letrat me vlerë të investimeve ashtu edhe për depozitat bankare. Nuk u identifikua asnjë dëmtim.</li></ul>
<p><b>Përfundimi i auditorit:</b> Bazuar në procedurat e kryera, letrat me vlerë të investimeve dhe depozitat me afat klasifikohen saktë dhe maten me kosto të amortizuar sipas SNK 39. Kërkesat e mbulimit të AMF u plotësuan. Ne nuk identifikuam një deklaratë të gabuar materiale.</p>	

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi.

- Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupit të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

### Raport mbi Kërkesat Ligjore dhe Rregullatore

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për njësitë ekonomike me interes publik, deklarojmë se:

- Emërimi i audituesit. Jemi emëruar si auditues ligjor nga Asambleja e Aksionarëve më datë 15/05/2025 dhe kemi shërbyer si auditues të Shoqërisë për një periudhë të pandërprerë prej 2 vitesh, duke përfshirë rinovimet përkatëse.
- Raporti shtesë për Komitetin e Auditimit. Opinioni ynë i auditimit mbi pasqyrat financiare është në përputhje me raportin shtesë të përgatitur për Komitetin e Auditimit, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 44, datë 30.09.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
- Shërbimet jo-audituese. Gjatë periudhës së angazhimit nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese dhe çdo shërbim tjetër i ofruar, nëse ka, është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi.
- Pavarësia. Ne kemi mbetur të pavarur gjatë gjithë periudhës së angazhimit, në përputhje me kërkesat etike, ligjore dhe rregullatore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

25 maj 2026



Erjona Isufi

**Sigma Vienna Insurance Group sh.a.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**

*Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>AKTIVET</b>			
Aktive afatgjata materiale	10	309,350	274,464
Aktive afatgjata jo-materiale	11	37,905	35,955
Aktive të mbajtura për investime	12	72,870	72,617
Aktive me të drejtë përdorimi	13	159,956	169,779
Aksione në shoqëri të lidhura	14	26,689	26,689
Aktive të risigurimit	15	3,862,192	3,670,565
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	16	3,496,710	3,618,830
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm	38	37,307	-
Depozita me afat me bankat	17	3,011,478	2,297,938
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	18	413,667	390,329
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	19	231,552	228,693
Aktive të tjera	20	59,175	77,860
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	21	300,768	319,595
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>12,019,619</b>	<b>11,183,314</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	22	498,213	498,213
Rezerva e rrezikut të sigurimit	23	393,049	393,049
Rezerva e rivlerësimit	23	69,190	44,796
Rezerva e bashkimit	23	308,207	308,207
Rezerva e përkthimit		(172,779)	(164,437)
Fitime të pashpërdara		899,983	893,247
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>1,995,863</b>	<b>1,973,075</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime për kontratat e sigurimit	24	5,689,692	5,370,470
Rezerva për primet e pafituara	29	2,149,875	1,903,163
Detyrime tatimore të shtyra	38	8,001	3,697
Detyrime tatimore dhe të tjera të ngjashme	25	40,742	36,612
Tatim mbi fitimin		-	9,974
Detyrim për qira afatgjatë	13	168,993	177,858
Depozita e risiguresit	26	1,569,569	1,354,233
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	27	396,884	354,232
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>10,023,756</b>	<b>9,210,239</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>12,019,619</b>	<b>11,183,314</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i shoqërisë më datë 19 Maj 2026, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Klaidi Çitozi  
 Administratori



Ilir Elmazi

VIG Services SH.P.K. – kontabiliteti dhe raportimi  
 financiar i shoqërisë

**Sigma Vienna Insurance Group sh.a.**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

*Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Prime të shkruara bruto	28	4,608,045	4,368,801
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	29	(254,984)	(151,982)
<b>Te ardhura nga primet e sigurimit</b>		<b>4,353,061</b>	<b>4,216,819</b>
Prime të çeduar të risiguruesit	30	(2,025,512)	(1,890,246)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara	29	74,274	54,874
<b>Të ardhura të primit të sigurimit të çeduar te risiguruesi</b>		<b>(1,951,238)</b>	<b>(1,835,372)</b>
<b>Të ardhura neto nga primet e sigurimit</b>		<b>2,401,823</b>	<b>2,381,447</b>
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	31	716,911	716,478
Të ardhura nga investimet	32	236,506	206,260
Të ardhura të tjera		15,000	12,109
<b>Të ardhura neto</b>		<b>3,370,240</b>	<b>3,316,294</b>
Dëme të paguara bruto	24	(1,772,793)	(1,775,442)
Dëme të paguara nga risiguruesi	24	654,776	542,591
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	24	(358,805)	(173,480)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit	24	153,525	133,298
<b>Dëmet neto të sigurimit dhe përfitime</b>		<b>(1,323,297)</b>	<b>(1,273,033)</b>
Shpenzimet të marrjes në sigurim	33	(831,484)	(763,128)
Shpenzime administrative	34	(782,233)	(750,854)
Shpenzime të tjera sigurimi	35	(56,575)	(48,747)
<b>Shpenzime</b>		<b>(1,670,292)</b>	<b>(1,562,729)</b>
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	36	(9,774)	(26,351)
Shpenzime financiare	37	(47,499)	(50,077)
<b>Fitim/(humbje) para tatimit</b>		<b>319,377</b>	<b>404,104</b>
Tatimi mbi fitimin	38	(68,223)	(82,723)
<b>Fitim/(humbje) e vitit</b>		<b>251,154</b>	<b>321,381</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Sigma Vienna Insurance Group sh.a.**  
**Pasqyra e ndryshimeve ne kapital**

*Të gjitha shumet janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Kapitali aksonar	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e përkthimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2024</b>	<b>498,213</b>	<b>393,049</b>	<b>308,207</b>	<b>48,773</b>	<b>(125,139)</b>	<b>756,614</b>	<b>1,879,717</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	321,382	321,382
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>321,382</b>	<b>321,382</b>
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Transferimi i rezervave	-	-	-	-	(39,297)	-	(39,297)
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	(188,726)	(188,726)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2024</b>	<b>498,213</b>	<b>393,049</b>	<b>308,207</b>	<b>44,796</b>	<b>(164,437)</b>	<b>893,247</b>	<b>1,973,075</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2025</b>	<b>498,213</b>	<b>393,049</b>	<b>308,207</b>	<b>44,796</b>	<b>(164,437)</b>	<b>893,247</b>	<b>1,973,075</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	251,154	251,154
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	28,372	-	-	28,372
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>28,372</b>	<b>-</b>	<b>251,154</b>	<b>279,525</b>
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Transferimi i rezervave	-	-	-	-	(8,343)	-	(8,343)
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	(248,395)	(248,395)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2025</b>	<b>498,213</b>	<b>393,049</b>	<b>308,207</b>	<b>69,190</b>	<b>(172,779)</b>	<b>899,983</b>	<b>1,995,863</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve te flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>319,377</b>	<b>404,101</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi	10,11,13	96,663
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve të mbajtura për investime	12	388
Zhvlerësimi për sigurimet e arkëtueshme	19	15,872
Shpenzime interes	37	39,294
Të ardhura nga investimet	32	(205,052)
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrime</b>	<b>233,284</b>	<b>351,270</b>
Ndryshime në të arkëtueshmet nga sigurimi e të tjera	(2,859)	(40,289)
Ndryshime në aktivet e tjera	18,685	39,267
Ndryshime në aktive të risigurimit	(191,627)	(25,070)
Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes së sigurimit	(23,338)	(27,105)
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit	319,222	13,950
Ndryshime në rezervën për primet e paguara	246,713	121,434
Ndryshime në depozitat e risigurimit	215,336	96,397
Ndryshime në detyrime të tjera	42,652	-
Ndryshime në të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	(5,844)	41,892
Ndryshime në mjete monetare të kufizuara	-	-
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit përpara interesave dhe taksës</b>	<b>852,223</b>	<b>571,746</b>
Interesi i arkëtuar	221,842	278,853
Interesi i paguar	(37,045)	(36,427)
Tatim fitimi i paguar	(40,890)	(94,509)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<b>996,385</b>	<b>719,663</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale jo-materiale	11,12	(9,475)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(22,765)
Pakësim i aktiveve afatgjata materiale		(1,069)
Te ardhura nga letrat me vlerë me kosto të amortizuar		(112,460)
Rritje në depozitat me afat		(319,945)
Rritje në aksione në shoqëri të lidhura		-
<b>Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese</b>	<b>(683,156)</b>	<b>(465,714)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>		
Qira të paguara		(57,069)
Dividend i paguar		(188,726)
<b>Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese</b>	<b>(305,620)</b>	<b>(245,795)</b>
<b>Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>7,356</b>	<b>8,153</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fillim të vitit</b>	<b>316,887</b>	<b>272,288</b>
Efekt i kursit të këmbimit në mjetet monetare	(26,154)	36,446
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fund të vitit</b>	<b>22</b>	<b>316,887</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyra financiare.

Mbrojmë atë që ka vlerë për JU!

